

Emri

Marrëveshja në Shkup, Koxiasi pret përgjigje

Fq.3



EDITORIAL

Kërkoet një koncesioner për drejtësinë!

Fq.2



Visar Musliu
Duam fitore në të dyja përballjet

Fq.19

www.koha.mk **Koha**



Biznesmenë me 8-vjeçare

Fq.8

FORUM

J'accuse



Titullin e shkrimit të sotëm e huazova nga ai i letrës së shkrimtarit të madh francez Emil Zola, drejtuar Presidentit Francez. Me këtë letër të hapur, ai në vitin 1898, do të protestonte për dënimin e padrejtë me burg të përjetshëm, të oficerit ushtarak francez Drajfus - për kinse "spionazh". Më vonë, rigjykimi do ti vërtonte dyshimet e Zolës: se ishte një gjykim i padrejtë, prandaj ushtaraku francez me prejardhje hebreje do lirohej. Maqedonia nuk ka Emil Zola, e as President të Francës. Ka pak intelektualë, edhe më pak politikanë të guximshëm, që pranojnë

Fq.10

RAJON

Xhandarmëria serbe futet në territorin e Kosovës!

Fq.14

FORUM

ALMIRI, simboli i një shteti që po e vrasim

Fq.11



SOPOTASIT NË LIRI, NË LIRI EDHE SKENARISTËT E RASTIT

SOPOTI, DSK-në NUK KA KUSH E DËNON!

Rrëfimi, të cilën pjesëtarët e DSK-së e kanë dhënë para Trupit gjykues, ka vërtetuar se dëshmitari Bajrami atëkohë ka qenë i privuar nga liria në mënyrë joligjore. Mes periudhës 23-29 maj 2003, Bajrami, sipas provave të PSP-së, ka qenë i torturuar nga Robert Ivanovski, Boban Stojanovski, Ilija Smilevski, Mile Vellkovski, Marjan Nikollovski dhe Mile Andonovski - që të gjithë inspektorë të DSK-së



Fq.6

"Iliqi nuk është fajtor për vrasje me paramendim"

Shkup, 20 mars - Kryeprokurori i shtetit, Lubomir Jovevski, në një intervistë për portalin "Makfaks", ka njoftuar se ka zhvilluar një takim me prindërit e vogëlushit të ndjerë, Almir Aliu nga Kumanova. Takimin me të prindërit dhe familjarët e Almiri, siç thotë kryeprokurori Jovevski, e ka realizuar me të vetmin qëllim - t'ju tregoj atyre se në vendimin për rikualifikim të veprës penale "vrasje me paramendim", për të

akuzuarin Boban Iliqi nuk ekziston asnjë prapavijë. Drejtësia, sipas tij, do të jetë e kënaqur, ndërsa sundimi i Ligjit doemos duhet të sundoj. Ai, në këtë intervistë këmbëngulë se në rastin konkret, nuk ekziston asnjë prapavijë etnike apo diçka të ngjashme. Kryeprokurori për "Makfaks", po ashtu ka theksuar se lëndën kundër Iliqit e ka shqyrtuar dhe se aktakuza kundër tij është e mbështetur...

Fq.5



EDITORIAL

KËRKOHET NJË
KONCESIONER
PËR DREJTËSINË!

Lirim DULLOVI

Mungesa e kapaciteteve profesionale e etike në sistemin e drejtësisë në Maqedoni, do të mundej të tejkalohet vetëm me kusht që komplet institucionet e gjyqësisë e prokurorisë të kalojnë në menaxhim ndërkombëtar, që ndryshe i bie dhënie me koncesion Bashkimit Evropian. Në një periudhë që do të caktohet paraprakisht, koncesioneri i drejtësisë, do të mendohej t'i bëjë reformat e duhura në drejtim të sundimit të ligjit dhe të përgjithësisht të drejtës në gjithë territorin e vendit.

Se drejtësia aktuale dhe ajo e kaluar ka funksionuar në mënyrë selektive edhe në baza etnike, e vërtetoi së fundmi rasti i Sopotit. Kjo praktikë do të konstatohet së shpejti edhe me rastin tjetër - Monstra, ndërkohë që mbeten për t'u hapur edhe disa raste të tjera, për të cilat opinioni tash më ka ngritur dyshimet e veta. Ky sistem, ku janë të përfshirë hetues, ekspertë të ndryshëm, pjesëtarë të policisë sekrete e publike, prokurorë, gjykatës dhe politikanë, funksionon edhe sot e kësaj dite. Këtë e vërteton rasti i fundit me rikualifikimin e veprës në vrasjen e Almir Aliut.

S'do mend se ky sistem vazhdon të prodhojë irritim, edhe përkundër kritikave të mediave dhe pakënaqësive publike të shprehura nëpër protesta. Ç'të thuash për këtë sistem (pa)drejtësisë, i cili është imun edhe ndaj vërejtjeve të faktorëve ndërkombëtarë, por edhe mosreflektues ndaj distancimit të kolegëve prokurorë shqiptarë, të cilët me veprimin e fundit në Prokurorinë Shtetërore, e shpërfaqën botërisht qëndrimin e tyre se vendime të ngjashme skandaloze në të ardhmen nuk do ta kenë edhe legjitimitetin e tyre. Shembullin e tyre, madje duhet ta ndjekin edhe gjithë bartësit e funksioneve publike e shtetërore, të cilët në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojnë që pjesëmarrja e tyre nëpër institucione të shërbejë si indigo për reprodukimin e vendimeve arbitrare kundër shqiptarëve. Në rrethana normale, ky standard do të duhej të ngritet nga politika, gjegjësisht nga ministri i Drejtësisë, si njeriu kryesor që duhet të iniciojë reformat e këtij sistemi të qelbur dhe që ka humbur plotësisht besimin e qytetarëve. Për fat të keq kjo nuk po ndodhë, edhe pas precedentit pozitiv me reagimin dhe distancimin e katër prokurorëve shqiptarë.

Alternativa mbetet në prishjen e tërësishme të këtij sistemi dhe fillimin e ndërtimit nga e para, ose, kalimi i gjithë kompetencave për reformimin e drejtësisë nga autoritetet vendore, në ato me relevancë ndërkombëtare. Edhe pse bashkëvendësit tanë maqedonas kanë aversion ndaj ideve për protektorat, duhet ta pranojmë faktin se ne rastin konkret mungojnë kapacitetet vendore për të kthyer kredibilitetin e humbur të njerëzve në sistemin e drejtësisë. Se protektorati ka edhe anët e veta pozitive, do ta marrim si shembull përvojën e Kosovës në disa segmente, siç ishte rasti me policinë, Doganat dhe Drejtorinë Tatimore, ku që nga themelimi i tyre, aty u përfshinë ndërkombëtarët, të cilët edhe sot vëzhgojnë nga afër zhvillimet dhe politikat në këto institucione. E njëjta situatë ishte edhe me Agjencinë Kosovare për Akreditim, që kishte edhe përfaqësues ndërkombëtar, deri në momentin kur me vendim politik u shkarkuan anëtarët e saj. Si pasojë, sot Kosova është përjashtuar nga Komiteti i Regjistrimit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

PA DREJTËSI - S'KA KA QETËSI (NEMA PRAVDA - NEMA MIR), ishte një nga motot e Revolucionit Laraman. Nëse politika vendore s'ka ide dhe vullnet për ndryshimin e kësaj situatë, atëherë do të duhej t'i hapte rrugë ideve për dhënie të tërësishme të drejtësisë me koncesion. Në të kundërtën, ky sistem do të vazhdojë të mbrojtë edhe në të ardhmen krimin dhe korrupsionin e zyrtarëve të ndryshëm të shtetit, si dhe do të shndërrohet në gjeneratori krize me përmasa ndërkombëtare, si uverturë e një destabilizimi më të madh të vendit dhe rajonit.

DILNI NESËR NË PROTESTË

"Njerëz të dashur, dilni nesër (sot) në protestë. Kjo që i ndodhi engjëllit Almir, Sametit të Sopotit me shokë, Fadilit, Rexhailit, Burhanit, Ajetit dhe mbi 58 shqiptarëve të dënuar me burg të përjetshëm me dëshmitarë të fshehur - shpifur, derisa janë në funksion këta gjykatës-monstra, mundet të të ndodhë edhe TY, që je duke i parë protestat në TV dhe thua: nuk zgjidhen këto punë me protesta. Mos harroni se vetëm Grupi i Kumanovës (745 vjet burg) është dënuar më rëndë se të gjithë oficerët nazi-fashist në Gjyqin e Nyrnbergut. Protesto për vete, me siguri edhe ty të është bërë ndonjë padrejtësi. Dil, dil, diiii!!", shkruan në profilin e tij në FB, veprimtari i çështjes kombëtare, Shpëtim Pollozhani.



REAGIMI I SHTETIT, ZERO

"Gruri për kafshë u importua në Kosovë si grurë për konsum për njerëzit. Mishi industrial i vjetër 12 vjet për kafshë është shitur në Kosovë për njerëzit. Shpesh lexojmë qysh po ushqehemi me ushqim të kafshëve, ndërsa reagimi i shtetit është zero. Kurr nuk kisha besuar që jeni në gjendje me na trajtu sikur kafshët edhe me ushqim, mirë që nuk është në mundësinë e juaj se edhe tek veterinari na kishit dërguar për kontrolle mjekësore!", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari kosovar, Mefail Bajqinovci.



TË VEPROSH SI VETËVENDOSJA

"Nëse do të kisha ndikim tek partitë rivale të Vetëvendosjes, te PDK, LDK, AAK, Nisma dhe DP, do t'i këshilloja që të mos shpenzonin kot para dhe energji për të penguar e përçarë Vetëvendosjen e për të bërë fushata e propaganda negative kundër figurave të Vetëvendosjes dhe Albin Kurtit. E vetmja mënyrë për ta fituar edhe ata simpatinë e mbështetjen qytetare është të veprojnë dhe ata si Vetëvendosja, pa inate, pa hakmarrje, pa u korruptuar, në të mirë të vendit, të shoqërisë e të kombit", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Arbër Zaimi.



KUR NDODHI KATASTROFA JONË KOMBËTARE?

"Katastrofa jonë më e madhe kombëtare, gjeokulturore dhe gjeopolitike nisi në vitin 1054, kur Kisha Romake u nda në dysh dhe Shqipëria i takoi Bizantit. Një mijë vjet u deshën për të rinisur rrugën drejt tokës së premtuar, pjesë e së cilës ishte, në Perëndim. Është një rrugëtim, që nuk u zgjidh dot gjatë mbi 100 viteve të shtetit të pavarur të Shqipërisë. Është një kalvar diplomatik, që vazhdon edhe sot e kësaj dite", ka shkruar në profilin e tij në FB, diplomati dhe studiuesi nga Tirana, Shaban Murati.



MEDIACitate

Delegacionet e Prishtinës dhe Beogradit takohen sot në Bruksel për të vazhduar dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Bisedimet do të zgjasin deri më datën 21 mars. Tema të diskutimit siç bëhet e ditur nga të dy delegacionet, janë marrëveshja për asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë, çështja e energjetikës, ura kryesore mbi Lumin Ibër në Mitrovicë, liria e lëvizjes dhe integrimi i menaxhimit të kalimeve kufitar. Për të gjitha këto çështje ka marrëveshje të nënshkruara kohë më parë, por që në praktikë disa nuk zbatohen fare e disa nuk zbatohen kënaqshëm. Takimi i fundit i dialogut teknik ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit u mbajt në muajin shkurt, pas më shumë se një viti ndërprerje. Beogradi zyrtar ndër marrëveshjet më të rëndësishme me Kosovën dhe që e kërkon me këmbëngulje, vlerëson krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, komuna, të cilat do të kenë më shumë autonomi brenda Kosovës. Prishtina zyrtare nga ana e saj thotë se Kosova do ta themelojë asociacionin e komunave me shumicë serbe, por, vetëm në bazë të kushtetutës së Kosovës. Presidenti i Serbisë Aleksandër Vučić, ka thënë se Prishtina zyrtare nuk është e interesuar ta themelojë asociacionin, pavarësisht zotimit që e ka dhënë në marrëveshjen Kosovë-Serbi në prill të vitit 2013 ku parashihet normalizimi i raporteve ndërmjet dy vendeve. "Jam pothuajse i bindur se nuk ka asgjë nga ajo punë. Nëse ata do të dëshironin ta themelonin asociacionin e komunave me shumicë serbe, ata do ta bënin atë në pesë vitet e fundit, por nuk kanë lëvizur as gishtin. Unë jam i bindur se nuk kanë ndërmend ta bëjnë këtë dhe për këtë ata kanë pasur pëlqimin e heshtur të një pjese të mirë të bashkësisë ndërkombëtare", tha Aleksandër Vučić dy ditë më parë në një fjalim drejtuar qytetarëve të Serbisë. Por kreu i delegacionit kosovar në bisedimet teknike me Serbinë, Avni Arifi, para nisjes për në Bruksel, u shpreh se Prishtina do ta themelojë asociacionin në bazë të kushtetutës së Kosovës. (DW, 20 mars)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË DIHET PËR HISTORINË E TEPELENËS?

Vendbanimi i hershëm i Tepelenës lidhet me një kështjellë të shek.IV-VI të ngritur në këtë pikë strategjike në kryqëzimin e rrugëve gjatë Vjosës në daljen nga gryka e Këlcyrës, gjatë Drinosit dhe për në Mallakastër. Kështjella u meremetua në shek.XI-XII, gjurmë të saj ruhen ende në perëndim. Ajo u shkatërrua gjatë pushtimit osman dhe me gurët e saj më 1492 u ndërtua një kështjellë më e vogël, pak

më në veri, e cila ruhet edhe sot. Në shek.XVII Tepelena kishte 250 shtëpi. Më 1789 e shtiu në dorë Ali Pashë Tepelena, që ngriti aty edhe saraje të vetat. Më 1819 Ali Pasha përfundoi një kështjellë prej 4-5 ha, me 3 hyrje dhe 3 kulla. Brenda saj ishin mjediset për garnizonin dhe banesa të tjera. Deri më 1820 Tepelena ishte rezidenca e dytë e Ali Pashës, pas Janinës.

"Më lejoni t'ju jap diçka ekskluzivisht. Kemi përpiluar tekst me propozimet tona në mënyrë të plotë në lidhje me çështjet e hapura të cilat i kemi me IRJM, ashtu edhe për agjendën e ardhshme bashkëpunuese e cila do të sjellë përfitime për të dyja palët. Këtë tekst e kemi dërguar para disa ditësh në Shkup", tha shefi i diplomacisë greke

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 20 mars - Teksti i marrëveshjes për emrin, i cili i përmban propozimet greke dhe agjenda për bashkëpunim të ardhshëm tashmë është dorëzuar në Shkup. Kështu ka njoftuar shefi i diplomacisë greke, Nikos Koxias, në Bruksel, pas mbledhjes së Këshillit për punë të jashtme të BE-së. Dy ditë para vizitës në Maqedoni, Koxias u ka thënë mediave se propozimet nga Athina tanimë janë dorëzuar, ndërsa ka konfirmuar se teksti i marrëveshjes përmban 20 faqe me 55 paragrafe.

"Më lejoni t'ju jap diçka ekskluzivisht. Kemi përpiluar tekst me propozimet tona në mënyrë të plotë në lidhje me çështjet e hapura të cilat i kemi me IRJM, ashtu edhe për agjendën e ardhshme bashkëpunuese e cila do të sjellë përfitime për të dyja palët. Këtë tekst e kemi dërguar para disa ditësh në Shkup", tha shefi i diplomacisë greke. Nikos Koxias tashmë edhe zyrtarisht është konfirmuar se më 22 dhe 23 mars do të jetë për vizitë zyrtare në Maqedoni. Ministria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë ka njoftuar se të enjten, delegacio-

NË PRAG TË VIZITËS SË SHEFIT TË DIPLOMACISË GREKE

MARRËVESHJA ËSHTË NË SHKUP, KOXIASI PRET PËRGGJIGJE NGA ZAEVI



ni grek i udhëhequr nga Koxias, do të mbërrijë të enjten në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit.

Lajmi i vizitës u konfirmua në të njëjtën kohë edhe nga pala greke, përmes zëdhënësit të Qeverisë Dimitris Xanakopoulos. Koxias do të takohet në fillim me homologun e tij, Nikolla Dimitrov, si dhe me shefin e Qeverisë, Zoran Zaev. Në këto takime, të dyja palët do t'i diskutojnë pikat e tekst-marrëveshjes, ndërsa më 30 mars në Vjenë, do të kenë takim të ri me ndërmjetësuesin e KB-së në negociatat për emrin Methju Nimic. Megjithatë, lideri i Grekëve të Pavarur dhe partneri i koalicionit në Qeverinë greke, Panos Kamenos edhe njëherë e përsëriti qëndrimin e tij të fuqishëm nga i cili, siç thotë nuk heq dorë. Paralelisht, tha se parakusht për zgjidhje është ndryshimi i Kushtetutës së Maqedonisë.

"Për emrin Maqedoni është e qartë qëndrimi i Grekëve të Pavarur. Nuk pranojmë asnjë zgjidhje që do ta përfshijë emrin Maqedoni. As Maqedoni Veriore, Jugore, Lindore

e as Perëndimore. Maqedonia është një dhe greke, Maqedonia siç e përshkruajti Konstatinos Karamanlis. Në rend është IRJM Shkup, të bëjë ndryshime kushtetuese. Eja të shohim. Greqia ka bërë mjaft hapa. Gjithsesi se duam zgjidhje, pa shtimin e termit Maqedoni. Ndryshimi i Kushtetutës është parakusht për çfarëdo zgjidhje tjetër", thotë Kamenos. Siç njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, lideri i Grekëve të Pavarur tha se në qe-

veri "ekzistojnë tema të cilat publikisht janë sqaruar, se nuk mund të ndryshohen qëndrimet as nga njëra e as nga partia tjetër". Por tha se qeveria e koalicionit, do të arrijë deri në fund të mandatit. Panos Kamenos, siç publikoi dje MIA sot do të takohet me Aleksis Ciprasin. Takimi i të dy partnerëve të koalicionit, e paralajmëroi zëdhënësi i qeverisë greke, Dimitris Xanakopoulos, ndërsa temë kryesore do të jetë rasti me dy ushtarët grekë të

RUSIA PARALAJMËRON MAQEDONINË PËR PASOJA NEGATIVE NËSE HYN NË NATO E BE

Zëvendës ministri i Jashtëm rus, Aleksandar Grushko, dje realizoi takim me ambasadorin e Maqedonisë në Rusi, Goce Karajanov. Sipas njoftimit të MPJ-së ruse bëhet e ditur se në takim u bisedua për çështjet bilaterale dhe këmben mendime për situatën në Ballkan. Grushko theksoi se planet e Maqedonisë për integrim në NATO dhe BE mundet të kenë pasoja negative në sigurinë rajonale por edhe në çështjet bilaterale.



arrestuar afër Evros në territorin turk. Duke marrë parasysh se ky takim është vetëm disa ditë para vizitës së Koxiasit në Shkup, mbetet enigma nëse të dy partnerët e koalicionit në takimin e tyre do ta përmendin çështjen e emrit.

PRESIM AVANCIM NË NEGOCIATAT

I presim komentet dhe vërejtjet e palës tjetër pas projekt marrëveshjes së dërguar dhe presim të bëhen hapa drejt avancimit, tha zëdhënësi i Qeverisë greke Dimitris Xanakopoulos, në brifingun e djeshëm të rregullt me gazetarët, duke u përgjigjur në pyetjen e korrespondentit të MIA-s nga Athina, në lidhje me pritjet e Greqisë në prag të vizitës së shefit të diplomacisë greke Nikos Koxias në Shkup. "Presim të bëhen hapa drejt avancimit. I presim komentet dhe vërejtjet e Qeverisë së IRJM-së dhe shpresojmë se do të kemi sukses të gjejmë një terren të përbashkët të takimeve të ardhshme. Megjithatë, kjo në masë të madhe varet edhe nga pala tjetër", tha Xanakopoulos. Duke e pasur parasysh atë se në periudhën e fundit,

në Athinë gjithnjë e më shpesh përmendet revizioni i Kushtetutës së Maqedonisë, megjithatë pa ekzistuar sqarim çka saktë do të thotë ajo, korrespondenti i MIA-s nga Athina kërkoi nga zëdhënësi i Qeverisë greke, nëse kërkesa greke për ndryshime kushtetuese ka të bëjë vetëm me emrin ose edhe për disa nene të Kushtetutës së Maqedonisë. Xanakopoulos sqaroi se projekt marrëveshja i përmban pozitat bazë të palës greke në negociatat, gjegjësisht "nevojën që të gjindet marrëveshje e pranueshme e përbashkët me emër të ndërlikuar që do të vlejë erga omnes, gjegjësisht për përdorim gjithëpërfshirës, diçka për çka parakusht është edhe ndryshimi adekuat kushtetues".

KRYEPARLAMENTARI GREK JEP ALARMIN

Deputetët po kërcënohen me vdekje

Athinë, 20 mars - Vdekje apo burgim të përjetshëm për ata deputetë të cilët votuan për emër të ndërlikuar, janë kërcënimet të cilat vijjnë nga organizatat maqedonase greke të dërguara përmes teksteve deri te anëtarët e Parlamentit grek, thekson kryeparlamentari Nikos Vucis. Vucis zbuloi se deputetët po marrin kërcënime me jetë, duke komentuar se "disa këtu kanë devijuar", transmeton korrespondenti i MIA-s nga Athina. "Depu-

tetëve grekë iu shpërndanë tekste nga përfaqësuesit e organizatave maqedonase greke nga jashtë vendi diçka që gojarisht e kemi dëgjuar, por nuk i kemi dhënë shumë rëndësi. Tani çdo deputeti i janë shpërndarë, ku as më pak e as më shumë na akuzojnë për tradhti dhe thonë se dënimi është vdekje apo burg i përjetshëm nëse dikush guxon të votojë për propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Qeverisë greke, nëse vjen

dhe kur të vijë në Kuvendin e Greqisë dhe nëse janë pjekur kushtet për emër të ndërlikuar", theksoi kryetari i Parlamentit të Greqisë. Sipas mediave greke, teksti me kërcënime nga organizatat greke nga diaspora deri te deputetët është përgatitur në 25 faqe, ndërsa aty, ata flasin për "shmangie antikushtetuese dhe jodemokratike të emrit të Maqedonisë" dhe pohojnë se të gjithë deputetët të cilët do të votojnë kundër kërke-



save të tyre, do të jenë fajtorë "për tradhti dhe pjesëmarrje të drejtpërdrejtë duke rrezikuar in-

tegritetin territorial të vendit, diçka që dënohet me burgim të përjetshëm dhe me vdekje".

HETIMET PËR 27 PRILL
JANË MBYLLUR

Çavkovi dhe deputetet pritet të lirohen



Shkup, 20 mars - Përfundimi i hetimeve për ngjarjet e 27 prillit nga Prokuroria për krim të organizuar, lë të hapur mundësinë që një pjesë e të akuzuarve, në mesin e të cilëve edhe ish-ministri Mitko Çavkovi, të lirohen nga paraburgimi dhe kështu t'ju shqiptohen masa më të lehta të kujdesit. Ky vendim duhet të miratohet nga Gjykata Supreme, pasi të martën në seancë publike pranë kësaj gjykate, u shqyrtuan ankesat e të akuzuarve nga Gjykata e Apelit. Këshilli i Penal i Gjykatës së Lartë, i kryesuar nga Jovo Vangelovski, Shpend Devaja, Xhemali Saiti, Risto Katavenovski dhe Rahillka Stojkova, të martën në seancë publike procedoi 13 nga gjithsej 15 ankesa, të cilat ishin të parashtruara nga ana e të akuzuarve për ngjarjet e 27 prillit. Në këtë seancë, diskutimet nga afër për masat e tyre i përcollën deputetet e VMRO-së Kërsto Mukovski, Sasho Vasilevski dhe Lupço Dimovski, ish-polici i parë, Mitko Çavkovi, gjegjësisht nëpunësi i Agjencisë për Zbulim, Munir Pepiq dhe tenori Igor Durllovski. Para gjykatësve në fjalë, pala mbrojtëse e të akuzuarve edhe njëherë sqaroi arsyet se pse këta të akuzuar duhet të lirohen nga masat e paraburgimit dhe paraburgimit shtëpiak. Paraprakisht, prokurorja e rastit, deri te ky Këshill Penal, dorëzoi propozim, ku rekomandohet se paraburgimet edhe masat tjera të kujdesit të miratuara nga Gjykata e Apelit, mundet të shfuqizohen, gjegjësisht të akuzuarit nuk mundet më të ndikojnë mbi procesin e hetimeve. Brenda 48 orëve, Jovo Vangelovski dhe kolegët e tij duhet të prononcohet për ankesat e këtyre të akuzuarve. (O.XH)

Në një analizë të kryer nga Komiteti i Helsinkit konstatohet se gratë e anketuara në pjesën më të madhe të rasteve jo vetëm që nuk arrijnë të kërkojnë të drejtat e tyre, por nuk arrijnë as të dallojnë nëse të drejtat e tyre janë të cenuara. Më konkretisht të drejtat e grave në zonat rurale konsiderohen si tema tabu, pasi bëhet fjalë për një traditë të vuajtjes, të nënshtrimit ndaj dominimit mashkullor

Koha Evis HALILI

Shkup, 20 mars - Me akses të kufizuar në shërbimet shëndetësore, kopshte e çerdhe, jeta e grave në zonat rurale nuk i shmanget dot hendekut gjithnjë e më të thellë të ndarjes së roleve tradicionale, duke ofruar më shumë barriera sesa mundësi për të jetuar më mirë. Në një analizë të kryer nga Komiteti i Helsinkit, konstatohet se gratë e anketuara në pjesën më të madhe të rasteve jo vetëm që nuk arrijnë të kërkojnë të drejtat e tyre, por nuk arrijnë as të dallojnë nëse të drejtat e tyre janë të cenuara, apo se për to duhet të ngrënë zërin. Më konkretisht, të drejtat e grave në zonat rurale konsiderohen si tema tabu, si pjesë e traditës së vuajtjes, të nënshtrimit ndaj dominimit mashkullor. Edhe pse konstatohet se jeta e grave rurale në përgjithësi dallon nga ajo e dekadave më parë, matrica patriarkale dhe përcaktimi i roleve mashkull-femër ndikon fuqishëm në organizimin e familjes dhe rolin e gruas në këto zona.

"Sipas pjesës më të madhe të të intervistuarave tradita duhet respektuar, por edhe kundrejt faktit që jeta e tyre është përmirësuar konsiderojnë se jeta në

ANALIZË E KOMITETIT TË HELSINKIT

TË DREJTAT E GRAVE NË FSHATRA, TEMË TABU



familjet e gjyshërve të tyre ka qenë më e lumtur, një pjesë thonë se gratë mund të kenë qenë më parë të paarsimuar, por kanë qenë më të urta dhe shtylla të familjes. Ato pohojnë se kanë më shumë barazi se më parë, por kur përshkruajnë sesi e kalojnë ditën krijohet përshtypja se jetojnë në botën e roleve të përcaktuara gjinore në bazë të stereotipave", thuhet në raport. Kryetarja e Komitetit të Helsinkit Uranija Pirovska vuri në dukje se tani që po hapet kjo temë tabu duhet të punohet më shumë për përmirësimin e jetës së këtyre grave në të gjitha drejtimet.

"Dëgjojmë shpesh për vajza të vogla në moshë që shiten, për adoleshente që lindin fëmijë, që braktisin shkollën, martohen dhe shndërrohen në krah pune në familje për të vetmen arsye se janë femra. Ne si organizata civile mund ta paraqesim vetëm si fakte, por veprimi duhet të ndërmerret nga ana e shtetit, e cila është përgjegjëse për t'i mundësuar atyre të drejta sociale, mbrojtje shëndetësore, arsimim", ka thënë

Pirovska. Problemet me të cilat hasin gra të moshave, etnive dhe edukimit të ndryshëm nuk kanë ndonjë dallim të madh. Një pjesë ankohen vetëm nga dhuna fizike që ushtrohet ndaj tyre, ndërsa atë psikike as që e llogarisin, përveç rasteve të grave që janë pjesë e organizatave për mbrojtjen e të drejtave të grave. Rastet e dhunës, si një prej shkeljeve më flagrante të të drejtave denoncohen në numër të vogël, jo vetëm për shkak se në disa rajone, si ai i Pollogut mungojnë qendrat e strehimit, por edhe nga paragjykimet e rrethit ku jetojnë dhe pabarazisë ekonomike.

"Një grua orvatej ta zgjidhte vetë problemin, sepse kishte denoncuare rastin, por fundi i saj ishte i keq, prandaj edhe nuk denoncojnë", shprehet një e anketuar. Sipas tyre askush nga komuniteti nuk i ndihmon viktimave, pasi këto çështje konsiderohen si private që duhet të zgjidhen brenda familjes. Disa prej grave shqiptare të anketuara pohojnë se nuk është i vogël

numri i rasteve kur dhuna ushtrohet jo vetëm nga burrat, por edhe gratë e tjera të bashkësisë familjare, si kunata dhe vjehrra. Në Pollog, aty ku edhe nuk ka qendra për strehimin e viktimave, në rastet e denoncimit të dhunës itinerari i dhunuarave kalon nga shtëpia e prindërve tek ajo e bashkëshortit.

"E ka denoncuar burrin, por thotë se nuk shpëton dot prej tij. Erdhi tek unë në shtëpi, mbante syze dhe nuk donte t'i hiqte, por ç'të shihja sytë i kishte të nxirë", thotë një pjesëmarrëse në këtë analizë. Si probleme të tjera në këtë analizë vijnë edhe një sërë të drejtash të tjera të cilat gratë nuk mund t'i realizojnë. Mbrojtja shëndetësore në një pjesë të madhe të fshatrave është e kufizuar, mungesa e ambulancave nga njëra anë, e sigurimit shëndetësor të një pjese të mirë të grave i privon nga aksesit i rregullt në shërbimet shëndetësore. Analiza e publikuar nga Komiteti i Helsinkit është pjesë e projektit të financuar nga ambasada e Britanisë së Madhe.

NJOHJA E LEJEVE TË VOZITJES NË EUROPE

Së shpejti marrëveshje me Gjermaninë dhe Slloveninë

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 20 mars - Tre shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, Austria, Spanja dhe Italia pranojnë lejet e vozitjes nga Maqedonia, ndërsa shumë shpejt do të pranohen edhe në Gjermani dhe Slloveni. "Maqedonia për momentin ka nënshkruar marrëveshje për pranimin e anasjelltas të lejeve të vozitjes me Spanjën, Italinë, Serbinë, Shqipërinë, Malin e Zi, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Austrinë vetëm për kategorinë B. Me Kosovën është harmonizuar marrëveshja dhe pritet së shpejti të nënshkruhet,

Njëherazi së shpejti do të nënshkruhet marrëveshja edhe me Gjermaninë dhe Slloveninë", thonë nga Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë (MPB).

Gjithashtu, merret vesh se të gjithë emigrantët nga Maqedonia që jetojnë apo kanë rregulluar vendqëndrimin në shtetet e BE-së si Spanja, Italia dhe Austria, me të cilët janë firmosur marrëveshje, do të mund të aplikojnë deri te Ministria e Komunikacionit të këtyre tre shteteve dhe të paisen me lejen e vozitjes së kategorisë B. "Mërgimtarët që kanë të rregulluar vendqëndrimin në shtetet më të cilët

kemi firmosur marrëveshjen për njohjen anasjelltas të lejeve së vozitjes mund të aplikojnë për marrjen e lejes së vozitjes të këtyre shteteve pa pasur nevojë ti nënshtrohen provimeve për leje vozitje. Ndërsa me të gjitha shtetet tjera të BE-së që ende nuk kemi nënshkruar marrëveshje, qytetarët që do të udhëtojnë në këto shtetet dhe qëndrojnë maksimum 6 muaj do të mund të vozisin me lejet e vozitjeve të lëshuara nga MPB-ja e Maqedonisë", thonë nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ndryshe, një muaj më parë mërgimtarët që jetojnë dhe punojnë në Gjermani

përmes një peticioni online kërkuar nga Ministria e Komunikacionit në Gjermani të pranon lejet për vozitje të shtetasve të Maqedonisë, lëshuar nga MPB-ja e Maqedonisë. Mërgimtarët e Maqedonisë pas nënshkrimit të peticionit Ministria e Komunikacionit në Gjermani u informuan se problemi nuk është aspak tek Gjermania, por tek Maqedonia. Mu për këtë nga MPB-ja e Maqedonisë informojnë se problemi është tejkaluar dhe se shtetasit Maqedonisë në Gjermani të cilët punojnë së shpejti do t'u pranohet leja e vozitjes lëshuar nga kjo ministri.

Qeveria e Maqedonisë ka nënshkruar marrëveshjet me tre shtetet e BE-së, Austri, Itali, dhe Spanjë, për njohjen e lejeve të vozitjes nga këto shtete, ndërsa në përfundimin janë obligimet për nënshkrimin e marrëveshjeve edhe me Gjermaninë dhe Slloveninë

JOVEVSKI MBRON VENDIMIN PËR RIKUALIFIKIM TË LËNDËS

Kryeprokurori ka theksuar se lëndën kundër Boban Iliqit e ka shqyrtuar mirë dhe se aktakuza kundër tij është e mbështetur në fakte dhe dëshmi që i ka në dispozicion



"ILIQI NUK ËSHTË FAJTOR PËR VRASJE ME PARAMENDIM"

Shkup, 20 mars - Kryeprokurori i shtetit, Lubomir Jovevski, në një intervistë për portalin "Makfaks", ka njoftuar se ka zhvilluar një takim me prindërit e vogëlshmit të ndjerë, Almir Aliu nga Kumanova. Takimin me të prindërit dhe familjarët e Almirit, siç thotë kryeprokurori Jovevski, e ka realizuar me të vetmin qëllim - t'ju tregoj atyre se në vendimin për rikualifikim të veprës penale "vrasje me paramendim", për të akuzuarin Boban Iliq nuk ekziston asnjë prapavijë. Drejtësia, sipas tij, do të jetë e kënaqur, ndërsa sundimi i Ligjit doemos duhet të sundoj. Ai, në këtë intervistë këmbëngulë se në rastin konkret, nuk ekziston asnjë prapavijë etnike apo diçka të ngjashme.

Kryeprokurori për "Makfaks", po ashtu ka theksuar se lëndën kundër Iliqit e ka shqyrtuar dhe se aktakuza kundër tij është e mbështetur në fakte dhe dëshmi që i ka në dispozicion.

"Në rastin konkret, në bazë të dëshmiave dhe ekspertizës së lëndës, prokurorja e cila e përfaqëson lëndën, ka konstatuar se në këtë rast nuk ekziston paramendimi, respektivisht dëshmitë nuk e vërtetojnë aktakuzën e cila fillimisht ka qenë për vrasje me paramendim", thotë kryeprokurori, Jovevski. Ankesa e parashtruar nga pala e dëmtuar, siç thotë kryeprokurori, është referuar deri te Prokuroria e Lartë e Shkupit, dhe më pas te ajo Republikania. Sipas tij, një numër i konsiderueshëm i prokurorëve, mbi 25 të tillë nga prokuroritë e vendit, janë shprehur se provat e mbledhura nuk e vërtetojnë aktakuzën e parë.

TË GATSHËM PËR ZBARDHJEN E RASTIT "ALMIRI"

Grupi parlamentar i BDI-së i jep mbështetje të plotë palës mbrojtëse në rastin e Almirit dhe kërkon që autori i kësaj vepre, Boban Iliq të merr dënimin e merituar. Deputeti Artan Grubi tha se nuk paragjykon rastin, por dëshmitë dhe pamjet e publikuara tregojnë fajtorin e vërtetë të rastit. Këto komenti deputeti i BDI-së i bëri pas takimit me avokatin Asmir Alispahiq. Ky i fundit tha se mbështetja e deputetit Grubi dhe gjithë shoqërisë në këtë rast jep shpresë për përfundim pozitiv të rastit. Për këtë rast të mërkurën është paralajmëruar edhe një protestë para qeverisë me moton "Pranverë pa drejtësi". Personi i cili doli nga paraburgimi, i cili kërcënoi gazetarë, i cili theksoi se është i gatshëm ta përsëris edhe një herë veprën, nuk e ka vendin në liri, por e ka vendin prapa grilave dhe nuk dua ta paragjykojë fajësinë por ama pamjet në video tregojnë qartasi fajin dhe kjo duhet të vërtetohet në një proces gjyqësor për vrasje e jo aksident trafiku", u shpreh për Alsat-M, Artan Grubi, deputet i BDI-së.

"Personalisht nuk kam presion politik. Mirëpo, nëse i ndjekeni kumtesat e disa partive dhe të Ministrisë së Drejtësisë, kjo mund të interpretohet si ndikim mbi punën e Prokurorisë Publike", tha Jovevski. Mes tjerash, ai ka shtuar se është i angazhuar që nga Prokuroria Publike të largohen "kthetrat" e politikës.

Përveç rikualifikimit të aktakuzës për Boban Iliqin, kryeprokurori Jovevski, në këtë intervistë, ka thënë se nuk e arsyeton letrën publike të katër prokurorëve publik shqiptarë, të cilët siç është shprehur Jovevski, kanë shkelur Ligjin për shërbim prokurorial.

Meqë lënda ende gjendet në procedure gjyqësore, ai tha se ky komunikim i prokurorëve shqiptarë me opinionin mund të ketë ndikim mbi Prokurorinë, por edhe mbi gjykatën. Lidhur me paralajmërimet për denoncimet e katër prokurorëve shqiptarë para Këshillit për etikë, Jovevski tha se do të pret të thirret seancë dhe kjo pikë të vendohet në rend të ditës.

NUK HESHTIM PA DREJTËSI TË PLOTË

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, duke komentuar rastin për Almirin e vogël, ka thënë se i vjen mirë që opinionin me shumë vëmendje është duke e ndjekur tërë procesin gjyqësor, është e zëshme dhe reagon për të gjitha aspektet. "Kjo bën që institucionet e sistemit përpos ato ekzekutiv, por edhe tjerët të jenë më të vëmendshëm dhe të përkushtuar në atë se çfarë reagojnë qytetarët. Kështu edhe pushteti ekzekutiv me vëmendje është duke e ndjekur këtë proces, dhe shpreson se nuk do të dërgon mesazh për përzierje në gjyqësor, por nuk do të mbesim të heshtur nëse për këtë proces si dhe për shumë të tjerë nëse nuk vjen drejtësia e plotë ashtu siç duhet të jetë", ka deklaruar kryeministri Zoran Zaev.



BESA e Afrim Gashit: E mbështesim protestën e për Almirin

Duke gjykuar se, fatkeqësisht, sistemi gjyqësor në Maqedoni ende vazhdon të jetë diskriminues dhe jo i drejtë ndaj shqiptarëve, Lëvizja BESA konstaton se lirimi i vrasësit të Almir Aliut dhe mundësia e rikualifikimit të veprës nga vrasje me paramendim në aksident trafiku, paraqet edhe një shembull tipik të kësaj qasjeje. Sidoqoftë, Lëvizja BESA, ashtu siç e ka ngritur zërin çdoherë kundër ndaj çdo padrejtësie - edhe kësaj radhe do të jetë gardiane e ngritjes së zërit shqiptar në Maqedoni, duke e mbështetur protestën për rastin e Almirit të vogël, e cila është paraparë të mbahet të mërkurën (21 mars) në Shkup. Nesër bashkërisht do t'i japim zë të fuqishëm protestës për Almirin, duke bërë që zëri ynë të jetë zëri i së drejtës në kohë dhe jo zëri i vonësës, siç ishte vite me radhë nga ministrat e (pa)drejtësisë të regjimeve të kaluara.

QMBI mbështet protestat

"Drejtësi për Almirin"

Qendra për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional (QMBI) mirëpret vendimin e një dite më parë të Prokurorisë Speciale Publike për të tërhequr padinë ndaj të akuzuarve të rastit "Sopoti" dhe shpalljen e tyre si të pafajshëm, si një vendim të drejtë dhe të shumëpritur, por që epilogun përfundimtar do ta sigurojë me marrjen në përgjegjësi dhe dënimin e të gjithë personave zyrtarë që kontribuuan në montimin e këtij procesi gjyqësor dhe me gjetjen e fajtorëve të vërtetë të këtij rasti. Në anën tjetër, siç thuhet në kumtesë QMBI dënon vendimin e Prokurorisë Publike për të rikualifikuar lëndën në rastin e vrasjes së Almirit të vogël, nga "vrasje" në "aksident komunikacioni me pasojë vdekjen", duke e vlerësuar këtë si një veprim tendencioz dhe të paprecedentë. "Me këtë rast, QMBI u bashkëngjitet zërave për dorëheqje të kryeprokurorit Jovevski dhe prokurorës së lëndës, Kusingerska, ndërsa i jep mbështetje të pa rezervë protestës së paralajmëruar për nesër, 21 mars, nga Iniciativa qytetare "Drejtësi për Almirin", para Qeverisë së RM-së, kundër rikualifikimit të lëndës në fjalë", thuhet më tej në kumtesën e QMBI.

ASH mbështet protestën

Jemi të dëshpëruar dhe të indignuar thellë nga vendimi i Prokurorisë publike për rikualifikim e veprës së Almirit nga "Vrasja" me paramendim në "Aksident Komunikacioni". Ky shtrembërim i drejtësisë jo vetëm që ngulfat shpresën e reformimit të sistemit të drejtësisë, po na bën të kuptojmë se gjykatat dhe prokuroria është ende selektive, e pa drejtë dhe politike. Aleanca për Shqiptarët po i bën të gjitha përpjekjet politike, që ky rast të ketë epilog të drejtë gjyqësor dhe vrasësi sa më shpejt të marrë verdiktin e merituar. Aleanca për Shqiptarët mbështet pa rezervë protestën "Drejtësi për Almirin" dhe njëkohësisht FTON aktivistët, por edhe gjithë qytetarët që të bëhen pjesë e një proteste të qetë dhe të qytetëruar duke ngritur zërin ndaj padrejtësisë së Almirit.

SOPOTASIT NË LIRI, NË LIRI EDHE MONTUESIT E RASTIT



SOPOTI,

Rrëfimi, të cilën pjesëtarët e DSK-së e kanë dhënë para Trupit gjykues, ka vërtetuar se dëshmitari Bajrami atëkohë ka qenë i privuar nga liria në mënyrë joligjore. Mes periudhës 23-29 maj 2003, Bajrami, sipas provave të PSP-së, ka qenë i torturuar nga Robert Ivanovski, Boban Stojanovski, Ilija Smilevski, Mile Vellkovski, Marjan Nikollovski dhe Mile Andonovski - që të gjithë inspektorë të DSK-së

DSK-në S'KA KUSH E DËNON!

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 20 mars - Dorëheqjen e aktakuzës dhe shpalljen të pafajshëm të shqiptarëve të Sopotit, Prokuroria Speciale Publike fillimisht dhe më pas Gjykata Penale e Shkupit, e kanë mbështetur në tre elemente kyçe. Biseda mes ish funksionarëve të lartë të MPB-së, Gordana Jankulovska dhe Sasho Mijallkov, rrëfimi i dëshmitarit të mbrojtur Ramadan Bajrami dhe deklaratat e nëpunësve të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërbulim, siç njoftuan nga PSP, hetimet e deritanishme kanë vërtetuar se për të akuzuarit e Sopotit nuk ekziston asnjë dëshmi relevante që i lidh ato me veprën penale "terrorizëm". Ish shefi i DSK-së, Sasho Mijallkov, sipas PSP-së, në bisedën mes tij me Jankulovskën, thotë se rasti i "Sopotit" është i montuar. Në fjalët përfundimtare, PSP theksoi se dëshminë e vetme për t'i dënuar sopotasit me veprën "terrorizëm", nëpunësit e DSK-së nga Ramadan Bajrami e kanë marrë nën presionin e dhunës, torturës dhe maltretimeve të ndryshme.

"Dëshmitari Ramadan Bajrami, në afërsi të postës së Kumanovës, ka qenë i arrestuar në mënyrë jashtëligjore. Ky veprim është kryer nga pjesëtarët e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërbulim dhe i njëjti është dërguar në lokacion të panjohur. Mos respektimin e dispozitivave ligjore për arrestim, vërtetohen me Raportin e dokumentimit dhe mbikëqyrjes të datës 26.5.2003, të MBP-DKS-së. Në këtë Raport theksohet se personi Ramadan Bajrami, ka qenë i vëzhguar nga 19.05.2003 deri me 23.05.2003, dhe më 23 maj, ai është arrestuar nga pjesëtarët e MPB-së. Faktin se arrestimi dhe mbajtja e dëshmitarit ka qenë e jashtëligjshme vërtetohet edhe nga dëshmitë e prezantuar:

SHPËTOJNË MONTUESIT

Vjetërsia e veprës penale, e cila ka skaduar në vitin 2013, ligjërisht nuk mundëson përndjekjen penale të nëpunësve të DSK-së, të cilët e kanë montuar të gjithë këtë rast. Brenda 15 ditëve, Vendimi për lirim nga akuza i të dëmtuarave Sulejman Sulejmani, Hasan Klaiqi, Shaqir Sulejmani, Shaban Limani, Samet Lutfiu, Musa Klaiqi, Zenel Klaiqi e të tjerë, pritet të bëhet i plotfuqishëm dhe të njëjtit mundet ta fillojnë procedurën për kërkimin e dëmshpërblimit. Meqë e gjithë kjo procedurë ligjërisht është paraparë të zhvillohet para Ministrisë së Drejtësisë, pala mbrojtëse nuk pret asnjë lloj obstrukcioni dhe beson se brenda tre muajve, e gjithë kjo golgotë ndaj sopotasve do të kompensohet.

tuara: Libri për ngjarjet ditore të MPB-Sektorit për Punë të Brendshme Kumanovë dhe Regjistrin e MPB-DSK-së, në të cilën aspak nuk është shënuar emri i Ramadan Bajramit si person i arrestuar dhe i mbajtur. Këtyre dëshmime ju bashkohet edhe Vendimi për shqiptimin e masës së paraburgimit me datë 29.05.2003, nga gjykatësi hetues i Gjykatës së Kumanovës, në të cilën nuk është vërtetuar koha e arrestimit dhe nga kush është arrestuar Ramadan Bajrami. Në shkresat e kësaj lëndë nuk ekziston asnjë procesverbal për dorëzimin e personit, nuk ekziston procesverbal për mbajtje të personit, gjegjësisht nuk ekziston asnjë lloj dokumenti i shkruar për kohën e arrestimit të Ramadan Bajramit dhe mbajtjen e tij", tha prokurori special Burim Rustemi në arsyetimin e tij për dorëheqjen e aktakuzës për rastin e "Sopotit".

min e tij për dorëheqjen e aktakuzës për rastin e "Sopotit".

Në bazë të dëshmime verbale dhe deklaratave të dëshmitarëve të DSK-së, që janë dhënë me datë 2 mars të këtij viti, sipas PSP-së, agjentët sekret më 25 maj 2003, e kanë ndaluar Ramadan Bajramin, me çka dy prej tyre kanë zhvilluar bisedë në një objekt sekret të MPB-së. Rrëfimin të cilën pjesëtarët e DSK-së e kanë dhënë para Trupit gjykues, e ka vërtetuar faktin se dëshmitari Barajmi. Mes periudhës 23-29 maj 2003, dëshmitari Bajrami, sipas provave të ndryshme të PSP-së, ka qenë i torturuar nga pjesëtarët e DSK-së.

"Tezën se me dhunë i është marrë deklarata dëshmitarit Ramadan Bajrami e vërtetohet edhe një pjesëtar i DSK-së, i cili potencon se më 25 maj 2003, kur është zhvilluar

biseda me dëshmitarin Bajrami, gjatë kësaj bisedë, ky i fundit nuk ka thënë asnjë detaj që lidhet me rastin e Sopotit", tha prokurori Rustemi. Veprimet e kundërligjshme të pjesëtarëve të DSK-së, që e kanë hetuar rastin e Sopotit: Robert Ivanovski, Boban Stojanovski, Ilija Smilevski, Mile Vellkovski, Marjan Nikollovski dhe Mile Andonovski, PSP i ka vërtetuar edhe gjatë kohës kur dëshmitari Bajrami ka qenë i dorëzuar para Gjykatës së Kumanovës, ku i njëjti ka qenë i detyruar të japë deklaratë, siç kanë thënë agjentët e policisë sekrete.

Gjatë torturimit dhe keqtrajtit të Ramadan Bajramit, në një rast pjesëtarët e DSK-së, siç tha prokurori special Burim Rustemi, kanë bërë gabim dhe dëshmitarin në fjalë e kanë përfshirë si pjesë e aktakuzës, konkretisht si bashkëpunëtor, lëshim ky i cili dy ditëve është ndryshuar dhe personin në fjalë përsëri është propozuar si dëshmitar.

Ndryshe, sipas provave të konfirmuara të PSP-së, Ramadani ishte dërguar në një banesë në afërsi të Strumicës, ndërsa ishte lidhur për kaloriferi. Gjatë disa ditëve me radhë, i njëjti ishte keqtrajtuar psikikisht dhe fizikisht, deri në alivanosje, për ta përsërit keqtrajtimin nga fillimi. Madje, cigaret që

GPASHTË INSPEKTORËT E DSK-së QË SKENUAN SOPOTIN

Vetëm njëri nga gjashtë inspektorët e DSK-së që detyruan dhunshëm Ramadanin të dëshmojë në rastin e Sopotit është në pension. Mile Anonovski, pensionist, aktualisht është këshilltar komunal në Komunën e Kumanovës nga radhët e LSDM-së, si dhe sekretar gjeneral i Partisë Pensionistët e Bashkuar në Kumanovë, ndërsa Marjan Nikollovski, gjithashtu i

Kumanovës me prejardhje nga Sopotit, është profesor në Fakultetin e Sigurisë në Shkup. Robert Ivanovski, Boban Stojanovski, Ilija Smilevski dhe Mile Vellkovski vazhdojnë punën në DSK, ndërkohë që Bobani dhe Ilija kanë ushtruar detyra të larta në DSK, konkretisht në Drejtorinë e Analitikës dhe në Sektorin për ndarjen e certifikatave të sigurisë.



• Marjan Nikollovski



• Mile Andonovski

"Trajektorja" shtyhet për më 17 prill

Shkup, 20 mars - Gjykimi për lëndën "Trajektorja" e PPS-së që duhej të vazhdonte dje në Gjykatën Penale, është shtyrë për më 17 prill.

Gjykatësi Goran Boshevski tha se Dangov, si mbrojtës i deputetit Lupço Dimovski, duhet të shkojë në seancën gjyqësore në Gjykatën Supreme ku duhej të shqyrtohen ankesat për paraburgimet e të akuzuarve për dhunën në Kuvend më 27 prill të vitit të kaluar.

Në lëndën e "Trajektorja", të akuzuar janë ish-kryeministri Nikolla Gruevski, ish-zëvendëskryeministri Vladimir Peshevski, ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakieski dhe ish-drejtori i Agjencisë së Rrugëve Shtetërore, Lupço Georgievski. Të gjithë të akuzuarit dje erdhën në seancën gjyqësore

në të cilën duhet të shqyrtohen dëshmitë e materialit. Gjykatësi Boshevski në fillimin e seancës e refuzoi si të pabazë propozimin e mbrojtjes që SMS porositë të hidhen poshtë si dëshmi në këtë procedurë, sepse ato nuk mund të vlerësohen në këtë fazë, si dhe kërkesa për audioincizimet dhe raportet e ekspertizës të mos përdoren në procedurë si dëshmi materiale për shkak të pamundësisë që të konfirmohet autenticiteti i tyre.

Gruevski, Peshevski, Janakievski dhe Gorgievski janë të akuzuar se në gjysmën e dytë të vitit 2012 dhe gjatë vitit 2013 kanë ndërmarrë shumë veprime, me të cilat në procedurën për përzgjedhjen e kompanisë për ndërtimin e autostradës Milladinovc-Shtip dhe Kërçovë-Ohër i kanë shfrytëzuar dhe i kanë tejkualuar autorizimet. Ata para Gjykatës u shprehën se e kanë kuptuar aktakuzën, por se nuk ndjehen fajtorë.

Sipas PPS-së, me veprimin kundërligjor të të akuzuarve, kompania kineze "Sinohidro" fitoi interes pronësoro-juridik prej 155.117.256 eurosh, ndërsa vlera e dëmit paraqet dallim mes vlerës së çmimit të cilën si shtet ia paguajmë "Sinohidros" dhe çmimin që kjo kompani ua paguan prodhuesve.

Mbrojtja, në fjalimet e tyre hyrëse tha se do të tregojnë se me rrethanat dhe të dhënat me të cilat dispononin, të akuzuarit gjatë marrjes së vendimeve nuk është bërë veprim i kundërligjshëm.

KE PUBLIKON RAPORTIN PËR BURGJET E MAQEDONISË

MË MIRË I VDEKUR SESA NË BURG

Këshilli i Evropës vëren se shkalla e mbingarkimit është më shumë e lidhur me dënimet e gjata me burg, të cilat shqiptohen në Maqedoni. Në dobi të kësaj teze flet edhe fakti që mesatarisht mosha e të burgosurve (939 vjet) është më e lartë se sa në shtetet e tjera evropiane (33 vjet)



Koha Fisnik PASHOLLI

Bruksel, 20 mars - Këshilli i Evropës e publikoi raportin për gjendjen në burgjet në vendet e tyre anëtare për vitin 2016, në të cilin theksohet se Maqedonia shënon shkallën më të lartë sipas numrit të arratisjeve nga burgjet. Sipas të dhënave nga statistikat e burgut të Këshillit të Evropës (SoE) për Maqedoninë, me 66 arratisje në 3400 të burgosur, shkalla e arratisjeve në vitin 2015 (viti e fundit për të cilin Këshilli i Evropës disponon të dhëna), është më e lartë dhe arrin 188.7 në 10.000 të burgosur. Me këtë, Maqedonia është në vendin e parë në Evropë sipas shkallës së arratisjeve prej burgju. Vendi i dytë në tabelë është Finlanda, por larg me numër shumë më të ulët prej 10 arratisjeve në 3.000 të burgosur. Maqedonia shënon shkallë shqetësuese të arratisjeve edhe në vitin paraprak (2014) me 114 arratisje të 3.100 të

burgosurve, njofton korrespondentja e MIA-s nga Brukseli.

Autori i studimit, Marselo Abei, profesor i Kriminologjisë në Universitetin e Lozanës (Zvicër), për MIA-s deklaroi se nuk e di arsyen e saktë për këtë gjendje, por se një element nga përgjigja "ndoshta duhet të kërkohet në numrin e vogël të rojeve të burgjeve". Maqedonia, sipas raportit, është mes vendeve me shkallë më të lartë të të burgosurve për një rojtarë (shkallë prej 6.2) vetëm në Rumani dhe Moldavi ka shkallë më të lartë. "Në krahasim me shtetet e tjera evropiane, keni më pak personel në burgje, por gjithashtu edhe më pak investoni në të burgosurit me 13 euro për të burgosur në ditë", thotë Abei, Mesatarja në Evropë është 51 euro. Vendet skandinave investojnë më shumë dhe ato janë shtetet me numër më të vogël të të burgosurve. Maqedonia shënon edhe shkallë të lartë të stërngarkimit të burgjeve. "Numri i të burgosurve

Numri i të burgosurve në Maqedoni rritet në vazhdimësi prej vitit 2005 deri në vitin 2015, shkalla e rritje për 10 vjet është deri 60 për qind. Në vitin 2016 pak është zvogëluar numri i të burgosurve, por është shumë herët të thuhet nëse kjo e shënon trendin e ri të uljes

në Maqedoni rritet në vazhdimësi prej vitit 2005 deri në vitin 2015, shkalla e rritje për 10 vjet është deri 60 për qind. Në vitin 2016 pak është zvogëluar numri i të burgosurve, por është shumë herët të thuhet nëse kjo e shënon trendin e ri të uljes", deklaroi Abei.

Këshilli i Evropës vëren se shkalla e mbingarkimit është më shumë e lidhur me dënimet e gjata me burg, të cilat shqiptohen në Maqedoni. Në dobi të kësaj teze flet edhe fakti që mesatarisht mosha e të burgosurve (939 vjet) është më e lartë se sa në shtetet e tjera evropiane (33 vjet). Maqedonia ka shkallë më të ulët të grave të burgosurve se sa në shtetet e tjera evropiane, shton autori i studimit, që

mund të lidhet me statusin e gruas në Shoqëri. "Nuk kam sqarim të qartë, por në përgjithësi, sa më i madh është integrimi i grave në shoqëri, aq më i madh është rreziku ata të kenë sjellje kriminale. Me integrim shoqëror vjen edhe përgjegjësi, por edhe rreziqet. Maqedonia ka tre për qind gra në burgje, ndërsa mesatarisht në Evropë ky numër arrin pesë për qind", thotë Abei.

Për dallim prej shteteve të tjera evropiane, Maqedonia ka më pak shtetas të huaj të dënuar në burgje, por Këshilli i Evropës nuk disponon me statistika etnike për këtë fenomen dhe nuk ka mundësi të thotë nëse bashkësitë më të vogla etnike janë të përfaqësuara në burgje.

Lënda "Treqind" vazhdon më 23 mars

Shkup, 20 mars - "Bohemia Automobila Rous" ka marrë pjesë në tenderin për furnizimin e automjeteve për nevojat e MBP-së në vitin 2008 me kërkesë të drejtorit të atëherëshëm të "Porshe Maqedoni", Zllatko Mucunski. Për këtë dje dëshmoi pronarja e "Bohemia", Danilla Rous Mishevaska në Cjykatën Penale për lëndën "Treqind" në të cilën është i akuzuar ish-ndihmësinistri i Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski për furnizimin e 300 automjeteve për nevojat e MPB-së. Sipas Mishevskës, kompania e saj nuk duhej të marrë pjesë në një tender të tillë, sepse ata kanë qenë vetëm dilerë dhe se për këtë është nevojitur garanci më e madhe bankare. Ajo tha se ata nuk kanë qenë importues zyrtar, por me sugjerim të Mucunskit, ajo ka marrë pjesë dhe e ka fituar tenderin e MPB-së. Nga "Porshe Maqedoni" edhe janë paralajmëruar se nuk do të të marrë kurrfarë dobie nga shitja e automjeteve, por se ata automobila do të servisohehen në "Bohemia Automobila". Në seancën e djeshme dëshmuar edhe tre të punësuar në MPB, të cilët gjatë tenderimit të furnizimit të automjeteve, kanë qenë anëtarë në Komisionin për furnizim me ç'rast para gjykatës kanë theksuar se një pjesë e detajeve teknike për këtë furnizim nuk ka qenë ki njohur. Gjykata ka caktuar vazhdimin e seancës për më 23 mars, ku do të merren në pyetje edhe dëshmitarë të tjerë. Sipas të akuzuarve, Popovski me furnizimin e ka dëmtuar buxhetin e shtetit në vlerë prej 453.570 eurosh. Prokuroria Publike Speciale pohoi se Popovski tenderin për blerje, servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve ua ka ndarë firmave të cilat nuk kanë pasur ofertë më të lirë.

Rrahje në Qeveri, dy gra janë përleshur fizikisht

Shkup, 20 mars - Dy gra të punësuar në Qeverinë e RM-së mbrëmë janë përleshur fizikisht pas një zënke verbale. Siç kumtoi MPB-ja, në Sektorin e Punëve të Brendshme Shkup u lajmërua se në hapësirat e bodrumit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në lavanderitë, M.D. (34) dhe A.N. (40), të punësuar në lavanderitë gjegjësisht në SHPPP, pas zënkës së ndërsjellë verbale janë përleshur edhe fizikisht. Nga policia informojnë se punohet në zbardhjen e rastit..

ALEANCA PËR SHQIPTARËT MBËSHTETJE PËR TARA VARIN

Protestë kundër MASH-it

Gostivar, 20 mars - Dega e Gostivarit të Aleancës për Shqiptarët ka mbajtur protestë para godinës së Komunës së Gostivarit për shkak të vendimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me të cilin kryetari të komunës i janë marrë kompetencat për emërim dhe shkarkim të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme. Pjesëmarrësit në protestë me parulla të shkruara në gjuhën shqipe erdhën para selisë së komunës për, siç u tha, të shprehin mbështetje për

kryetarin Arben Taravarin në ballafaqim me "BDI-zimin" e institucioneve arsimore. "Mjaft me presione dhe bllokada. Kërkojmë kthimin e ingerencave të kryetarit i cili është zgjedhur me procedurë demokratike. Nëse e ka shkelur ligjin, u bëjmë thirrje organeve gjyqësore të marrin vendim, e jo këtë ta bëjë institucioni si MASH-it. Kërkojmë reforma të vërteta në të gjitha fushat e jetës, e jo fjalë të kota", tha në protestë Halil Snopçe, anëtar i kryesisë qendrore të

Aleancës për Shqiptarët. Kryetari Taravari në fjalimin e tij në tubim iu falënderua për mbështetjen, duke theksuar se vendimi i MASH-it është revanshizëm politik i koalicionit qeveritar. "Këtë e bëjnë që të më paraqesin si të paaftë dhe ta bllokojnë funksionimin e komunës të cilën e udhëheq. Pse nuk i marrin ingerencat e kryetarëve të tjerë të cilët kanë marrë hapa të kërtillë dhe paralajmëroi se protestat do të vazhdojnë në ditët në vijim me bllokimin e rrugëve në Komunën e

Gostivarit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës javën e kaluar e zbatoi vendimin e komisionit të shkallës së dytë, me të cilin janë pezulluar emërimet e drejtorëve në disa shkolla komunale në Gostivar të cilët i ka emëruar Taravari. Ky reagim i MASH-it pason pasi para një muaji kryetari të komunës i janë marrë kompetencat për emërim dhe shkarkim të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme. Kryetari i Gostivarit drejtpërdrejt pas marrjes së funksionit, emëroi

RAPORT I BANKËS BOTËRORE PËR BALLKANIN

BIZNESMENË ME 8-VJEÇARE, HYZMEQARË ME SHKOLLË TË LARTË!



EMIGRIMI NJEH NJË TJETËR KULM

Vendet e Ballkanit Perëndimor po vuajnë nga largimi i trurit pasi pjesa që po emigron është pikërisht pjesa me arsim të lartë. Banka Botërore vëren se ka një rritje të pjesës që zë popullsia që ka emigruar në raport me popullsinë totale, një raport që po thellohet duke zënë më shumë se 30 për qind. Saktësisht Shqipëria është e dyta në këtë renditje me 1.05 milionë emigrantë.

Shkup, 20 mars - Banka Botërore ka publikuar raportin e fundit për tendencat e punësimit, që merr në analizë treguesit në Ballkanin Perëndimor dhe disa vende të rajonit, që janë pjesë e BE-së në periudhën 2016-2017. Raporti sjell të dhëna interesante, që marrin një kontekst tjetër kur krahasohen në raport me rajonin dhe një prej tyre është pjesa e pagave të ulëta dhe përqendrimin të kësaj page në ekonomi. Sipas raportit përqendrimi i lartë i pagave të ulëta është udhëheqësi kryesor i pabarazisë së pagave në përgjithësi në rajon. "Mali i Zi dhe Bosnjë Hercegovina raportojnë nivelin më të lartë të pagave, kurse Shqipëria dhe Ma-

Një e dhënë tjetër interesante është edhe ajo e strukturës së punësimit tek popullsia në moshë pune. Sipas raportit, Maqedonia dhe Shqipëria mban rekordin e atyre që janë të vetëpunësuar, por që kanë nivel arsimimi 8 vjeçar. Kurse në rajon, pjesën më të madhe të të vetëpunësuarve e zënë ata që kanë arsim të mesëm

qedonia më të ultën" vlerëson raportin.

Një e dhënë tjetër interesante është edhe ajo e strukturës së punësimit tek popullsia në moshë pune. Sipas raportit, Maqedonia dhe Shqipëria mban rekordin e atyre që janë të vetëpunësuar, por që kanë nivel arsimimi 8 vjeçar. Kurse në rajon, pjesën më të madhe të të vetëpunësuarve e zënë ata që kanë arsim të mesëm. Punësimin më të lartë në sektorin privat, Shqipëria e raportoi në segmentin e atyre me arsim të lartë.

"Në mesatare, rreth gjysma e të vetëpunësuarve në Ballkanin Perëndimor ishin me shkollë të mesme. Në Bosnjë-Hercegovinë

dhe Kosovë më shumë se 60 për qind kishin një nivel arsimimi mesatar në 2016, më pak të arsimuarit ishin grupi i dytë më i madh mes të vetëpunësuarve, kurse ata me arsim të lartë zinin rreth 11 për qind në një mesatare. Në kontrast me këtë, në Shqipëri dhe Maqedoni shumica e të vetëpunësuarve ishin atë me nivel më të ulët arsimimi. Në termat e edukimit në total, punësimi u rrit në të gjitha grupet e edukimit, por më së shumti tek ata me arsim të mesëm në të gjitha vendet me përjashtim të Shqipërisë. Kjo e fundit raportoi rritjen më të madhe të punësimit në segmentin e atyre me arsim të lartë" thuhet në ra-

port. Ky lloj punësimi, sipas Bankës Botërore, ishte më pak i përhapur në vendet e Ballkanit Perëndimor duke zënë 11 për qind në vitin 2017.

"Shqipëria dhe Maqedonia ishin të vetmen që raportuan një shifër të lartë edhe pse me tendencë tkurrijeje për të punësuarit part-time që zënë 20 për qind të punësimit total. Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina ishin ato që pasonin me 10.6 për qind dhe 9 për qind. Në vendet e tjera të rajonit, punësimi part-time ishte 5-6 për qind. Kjo është e njëjtë me vendet e tjera pjesë e BE-së që i janë bashkuar këtij komuniteti mes 2004-2013" thuhet në raport.

KOMISIONI I VENECIA ME VLERËSIM PËR LIGJIN E RI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

LIGJI I RI JASHTË STANDARDEVE EVROPIANE

Komisioni i Venecias jep rekomandime të caktuara deri te përpiluesit e zgjidhjeve ligjore me qëllim që të përmirësohet cilësia dhe të sigurohet harmonizim me standardet ndërkombëtare apo evropiane

ritanishëm, megjithëse rekomandon sigurim të pavarësisë së vërtetë të Komisionit, posaçërisht me ndryshimin e dispozitave lidhur me zgjidhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të saj. Komisioni i Venecias jep rekomandime të caktuara deri te përpiluesit e zgjidhjeve ligjore me qëllim që të përmirësohet cilësia dhe të sigurohet harmonizim me standardet ndërkombëtare apo evropiane.

"Kërkohet të sigurohet pavarësi e vërtetë e Komisionit, posaçërisht me ndryshimin e dispozitave lidhur me zgjidhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të saj. Rekomandohet edhe rishikim i nenit 17 me qëllim që në përbërjen e Komisionit të sigurohet përfaqësim pluralist të gjitha forcave sociale, të përfshira në mbrojtjen dhe avancimin e barazisë. Komisioni i Venecias rekomandon që autoritetet të organizojnë procese të hollësishme konsultative shtesë jo vetëm me organizatat joqeveritare dhe ba-

shkësinë ndërkombëtare, por edhe me opinionin, posaçërisht me grupet e marginalizuara", thuhet në vlerësimin e Komisionit të Venecias. Ndërkohë si përfitim në zgjidhjet e reja ligjore, Komisioni i Venecias e përmend padinë për mbrojtje nga diskriminimi me interes publik (actio popularis).

"Shoqatat, fondacionet dhe organizatat e tjera të shoqërisë civi-

le, të cilat kanë interes të arsyeshëm për mbrojtjen e interesave të një grupi të caktuar apo në korniza të veprimtarisë së tyre merren me mbrojtje nga diskriminimi, mund të parashtrajnë padi nëse tregojnë se me veprimin e të paditurit diskriminohen një numër i madh personash", thuhet në propozim ligjin e ri. Si aspekt pozitiv i Komisioni i Venecias e

vlerësoi edhe atë që shoqatat relevante dhe organizatat e tjera mund të iniciojnë procedura në emër apo për mbështetjen e viktimave të diskriminimit, madje edhe nëse viktima konkrete nuk është përmendur. Ndryshe, ndryshimet më të rëndësishme kanë të bëjnë me pjesën e bazave të diskriminimit dhe pozitës të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi.

ÇFARË NËNKUPTON DISKRIMINIMI

Në zgjidhjen e re ligjore parashikohet se diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo dhënie përparësi që bazohet në racën, ngjyrën e lëkurës, origjinën kombëtare apo etnike, gjininë, orientimin seksual, përkatësinë e grupeve të marginalizuara gjuhën, shtetësinë, origjinën sociale, arsimin, religjionin apo bindjen fetare, bindjen politike, bindje të tjera, pengesa, moshën, gjendjen familjare apo martesore, gjendjen pronësore, gjendjen shëndetësore, cilësinë personale dhe statusin shoqëror apo në çfarëdo baze tjetër, të cilat kanë për qëllim ta pengojnë apo kufizojnë njohjen, gëzimin apo realizimin e të

drejtave të personave të caktuar apo grupeve në bazë të barabartë me të tjerët. Personat, të cilët vlerësojnë se kanë përjetuar diskriminim të parashtrajnë ankesë deri te Komisioni, procesverbale me shkrim apo me gojë, pa obligim për pagesën e taksës apo kompensim tjetër. Personi, i cili vlerëson se është diskriminuar mund të parashtrorë ankesë para Gjykatës kompetent civile. Në procedurë në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat nga Ligji për procedurë gjyqësore, përveç nëse me këtë ligj nuk është rregulluar më ndryshe. Kjo procedurë në pajtim me zgjidhjen ligjore është urgjente.

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 20 mars - Ligji i ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi ka numër të madh të aspekteve pozitive, megjithatë duhet pavarësi më e madhe si financiare ashtu edhe politike i Komisionit antidiskriminim. Kështu është vlerësimi i Komisionit të Venecias, i cili e shqyrtoi propozimin më 16 dhe 17 mars dhe konkludoi se ai është shumë më i mirë se Ligji i de-

Nga Komuna e Zhelinës akuzuan se përgjegjëse për këto përmbytje është Komuna e Tetovës, ndërsa kjo e fundit thonë se nevojitet formimi i një Komisioni, i cili do të dalë në terren dhe të konstatojë gjendjen reale për të gjetur një zgjidhje afatgjate për banorët e këtyre fshatrave

PËRMBYTJET NË TREBOSH, KËRKOHEM ZGJIDHJE



Mençe Atanasova Toçi fiton çmimin "Nikolla Mlladenov"

Shkup, 20 mars - Gazetarja e TV Nova, Mençe Atanasova Toçi është fituese e çmimit të parë "Nikolla Mlladenov" për storjen më të mirë hulumtuese për vitin 2017 që sot e ndau Instituti i Maqedonisë për Media. Toçi është fituese e çmimit të parë për serinë e teksteve për importin paralel të ilaçeve në vend, të publikuara në TV Nova me të cilin u zbulua falsifikimi i ilaçeve dhe keqpërdorimet serioze të qeverisë në drejtim të manipulimit të qytetarëve dhe manipulimit në çmimet e ilaçeve. Çmimin e dytë "Nikolla Mlladenov 2017" për storjen më të mirë hulumtuese e fitoi ekipi i gazetarëve të BIRN të publikuara për storjen hulumtuese "Investimet e huaja nën thjerrë", të publikuara në Prizmë. Çmimin e tretë e fituan Petar Klinçarski për storjen "Një mijë përktihme" dhe Liridona Vejseli për storjen "Ku është selia e xhihdistëve". IMM mirënjohje i dhuroi Sllavica Filipovskës për storjen "Sa kohë na duhet për të shkatërruar liqenin më të vjetër në Evropë" gjithashtu e publikuar në emisionin 360 gradë në Alsat M. Në konkursin vjetor janë parqitur 38 autorë prej gjithsej 60 storjeve të përpunuara në 154 tekste - kronika të publikuara në faqet e internetit, televizione, gazeta ditore dhe në javore. Çmimi për storjen më të mirë hulumtuese tradicionalisht ndahet për të 17-ën herë, si pjesë e përpjekjeve të IMM, për zhvillimin e gazetarisë profesionale dhe vlerave demokratike në vend.

PËRMBYTJET, PËRPLASEN ZHELINA DHE TETOVA

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 20 mars - Çdo herë kur ka reshje të shiut, kanali në të cilin rrjedh uji që vjen nga lumi i fshatit Poroj vërshon përgjatë rrugës së fshatit Trebosh dhe tokat bujqësore aty pranë. Pikërisht këto përmbytje kanë bërë që të ketë përplasje mes Komunës së Zhelinës dhe Tetovës. Nga Komuna e Zhelinës akuzuan se përgjegjëse për këto përmbytje është Komuna e Tetovës, ndërsa kjo e fundit thonë se nevojitet formimi i një Komisioni, i cili do të dalë në terren dhe të konstatojë gjendjen reale për të gjetur një zgjidhje afatgjate për banorët e këtyre fshatrave. "Ne si komunë jemi të interesuar që ky problem të zgjidhet mes institucioneve apo ndërhyrjeve kompetente të dy

komunave. Jemi të gatshëm të ofrojmë edhe ekspertë që janë në kuadër të komunës së Tetovës që të gjendet zgjidhje afatgjate për këtë problem sepse pësojnë dy fshatra që janë në territorin e komunës së Zhelinës", tha Armend Fazliu, zëdhënës i Komunës së Tetovës. Sipas kryetari i Komunës së Zhelinës, Blerim Sejdiu, thotë se vendi ku mblidhet uji dhe del nga shtrati i bie territorit të Komunës së Tetovës.

"Ky vend gjendet në hyrje të fshatit Trebosh, pra në rrugën kryesore. Më herët kemi kontaktuar edhe me Komunën e Tetovës që të jenë të njoftuar me këtë situatë që na përsëritet çdoherë kur ka të reshura dhe që të ndërhyhet, pasi nuk kemi të drejtë ligjore të ndërhyjmë në një territor të një komune tjetër", tha

kryetari i Komunës së Zhelinës, Blerim Sejdiu. Përfaqësues të Komunës së Zhelinës si drejtori i ndërmarrjes publike komunale "Mirëmbajtja", Sedat Rushani, së bashku me koordinatoren komunal të Qendrës për Menaxhim me Kriza, Shaban Limani, kishin dalur në vendngjarje për të mbikëqyrur situatën. Ata thonë se makineri të angazhuara nga Komuna e Zhelinës që nga orët e hershme të mëngjesit kanë ndërmarrë masa që uji të mos vërshojë edhe nëpër shtëpitë e banorëve të fshatit Trebosh. "Si primare ka qenë që uji të mos depërtojë në vendbanime, respektivisht në Trebosh dhe Pallaticë, ku ka rreth 6 mijë banorë. Ka përmbytje në tokat punuese dhe kërkojmë një bashkëpunim më të mirë me Komunën e Tetovës

për të tejkaluar këtë situatë dhe për të zgjidhur njëherë e përgjithmonë", tha Shaban Limani. Përndryshe, vërshimet e shpeshta të ujit në këtë rrugë në masë të madhe e kanë shkatërruar të njëjtën, që ndikon drejtpërdrejt në prishjen e automjeteve, të cilat për çdo ditë qarkullojnë në këtë rrugë, andaj kërkohet një zgjidhje urgjent dhe afatgjate si për kanalin që gjendet përgjatë kësaj rrugë, po ashtu edhe për rrugën, e cila është mjaft e frekuentuar dhe lidh disa fshatra të Komunës së Zhelinës me Tetovën. Qytetarët apelojnë që urgjentisht Komuna e Zhelinës të ndërmarrë masa në drejtim të përmirësimit të gjendjes në këtë rrugë, me qëllim që situata të mos eskalojë dhe uji të vërshojë edhe nëpër shtëpitë e këtij fshati.

Në dispozicion 80 milionë euro nga IPARD2

Shkup, 20 mars - Tërheqja e IPARD mjeteve duhet të sjellë deri te ndryshimet strukturore në bujqësinë e Maqedonisë, deri te ndryshimet në menaxhimin e ekonomitë bujqësore, prodhimtarinë dhe plasmanin, porositën pjesëmarrësit e debatit të djeshëm në Parlamentin e Republikën e Maqedonisë. Sipas tyre, IPARD është pjesë e politikës së përbashkët evropiane agrare (GAP) qëllimi i vetëm i së cilës është t'i përgatisë vendet e ardhshme anëtare të BE-së për shfrytëzimin e fondeve të saj strukturore.

"Sektori agrar dhe rural i Maqedonisë përballlet me shumë sfida, përmirësim të cilësisë së prodhimtarisë, konkurrencës në tregun rajonal, evropian dhe



botëror, modernizimin dhe hapjen e vendeve të punës. Por, para nesh qëndron edhe një sfida e madhe, shfrytëzimi i IPARD 2, program i cili deri në vitin 2023 vendit i ofron 80 milion euro", theksoi drejtori i Agjencisë pagesore, Nikolla Babovski. Interesi për IPARD 2 është i madh",

theksoi Babovski, duke marrë parasysh se në thirrjen e parë publike të realizuar vitin e kaluar janë dorëzuar numër rekord i kërkesave, 1.649, për mbi 73 milionë euro për bashkëfinancim. Drejtori konkretizoi se Maqedonia nuk i shfrytëzoi mjetet e mjaftueshme në para nga fondet e

BE-së, të projektuara me IPARD1 në periudhën 2007-2013.

"Deri në vitin 2015 janë publikuar 12 thirrje në të cilat u dorëzuan 3.087 kërkesa, ndërsa ishin lidhur 1.091 marrëveshje me mbi 16 milionë euro të paguara", tha Babovski. Ai potencon se shfrytëzimi i IPARD mjeteve është prioritet strategjik i Qeverisë dhe në këtë drejtim veçmë bëhen hapa konkret, formohet fondi garantues, ndërsa është përgatitur edhe plan aksionar për rritjen e kapaciteteve administrative dhe ngritjen e vetëdijes publike për nevojat e ndihmës evropiane. Në diskutim, i cili është në vijim, do të ndahen përvojat e Sllovakisë, ndërsa do të flasin edhe përfaqësuesit e institucioneve relevante nga vendi.

Burri abuzon mbi vajzën e mikut të familjes

Shkup, 20 mars - Një çift bashkëshortor nga Dellçeva dje ka denoncuar në polici, se, derisa nuk kanë qenë në shtëpi, një mik familjar ka abuzuar mbi vajzën e tyre minorene. Fëmijët në moshë prej 12 deri 14 vjeç kanë qenë në shtëpi me gjyshin e tyre, kur ka ardhur miku familjar. Rreth orës 22:30, djali u ka treguar prindërve të cilët ndërkohë janë kthyer, se miku e ka prekur motrën e tij nëpër trup në dhomën e ditës dhe i ka thënë të mos i tregojë askujt. Këtë ia ka treguar vajza vëlait të saj. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi nga Stacioni Policor në Dellçevë. Personi është thirrur dhe është mbajtur në polici. Kundër tij do të parashtrahet padi penale dhe gjatë ditës do të nxirret para Gjykatës në Koçan.

Titullin e shkrimit të sotëm e huazova nga ai i letrës së shkrimtarit të madh francez Emil Zola, drejtuar Presidentit Francez. Me këtë letër të hapur, ai në vitin 1898, do të protestonte për dënimin e padrejtë me burg të përjetshëm, të oficerit ushtarak francez Drajfus - për kinse "spiunazh". Më vonë, rigjykimi do të vërtetonte dyshimet e Zolës: se ishte një gjykim i padrejtë, prandaj ushtaraku francez me prejardhje hebreje do lirohej. Maqedonia nuk ka Emil Zola, e as President të Francës. Ka pak intelektualë, edhe më pak politikanë të guximshëm, që pranojnë të flijojnë: privilegjet para parimeve; materialen para idealeve dhe të vërtetën para karrierës.

Zola, ndërkaq pas kësaj letre, do i humbte të gjitha privilegjet shtetërore përfshi edhe "Urdhrin e Legjionarit të Nderit". Por, ai nuk kishte kalkuluar midis: fitimit apo humbjes personale. Para më shumë se një shekulli, ai kishte akuzuar gjyqësorin dhe shtetin për shkelje të ligjit dhe dënimin e një të pafajshmi. Ai kishte dëshmuar, kështu atdheadashuri për Francën, si shtet i së drejtës dhe i qytetarëve të barabartë. Maqedonia, është larg Francës. Këtu, ende kemi: deficit nacionalizmi dhe deficit patriotizmi. Nuk ka intelektual të kalibrit të tillë si Zola, por nuk ka as President si ai i Francës. Nuk ka kush, e as kujt ti shkruhet një letër e hapur. Sepse, ndërgjegjja që moti nuk banon këtu, kurse vetëdija është pa adresë. Preokupim politik mbeten vetëm zgjedhjet, sepse edhe shoqëria po sundohet nga vota. Mbrojtësit e tij, këtë e quajnë demokraci; kritikët - diktaturë elektorale. Fitoret zgjedhore nuk janë garancë për demokracinë. Pardje, Putini sërish fitoi absolutisht zgjedhjet presidenciale - për 18 vite rresht. Millosheviqi, i fitonte bindshëm zgjedhjet në Serbi për plotë 12 vite, sikur edhe Sadam Huesini në Irak dhe Gadafi në Libi e Asadi në Siri, për më shumë dekada rradhazi. Dhe kjo është demokraci? Apo vetëm demokraci?

Kur mendohej se gjykimi për rastin "Monstra" do të ishte i fundit i një gjyqësie selektive, mbivotimi i prokurorëve për ri-kualifikimin e vrasjes së Almirit, ia veshi këtij selektiviteti edhe petkun etnik. Ndarja e gishtave votues prokurorijal- mbi baza etnike- me imponim të Prokurorit të ri- të posazgjedhur, dëshmoi se sa larg jemi nga ç'kapja e shtetit. Vazhdimisht përsëritet se nuk do lejohet përzjerje në gjyqësor. E prokuroria nuk është gjykatë. Gjyqësori, pra, vështirë po zhvishet nga politika, e nuk po lirohet as nga mentaliteti i pronësisë një-etnike mbi shtetin.

J'accuse

Pribe në raportin e tij, para dy vitesh qartë udhëzoi se rruga drejt Brukselit shkon përmes drejtësisë; e atje nuk arrihet pa gjyqësor të pavarur. Gjykimi i drejtë është edhe një nga parimet e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë ishte paditur para Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, 11 herë - vetëm për shkelje të këtij parimi- pra të gjykimit të padrejtë. Nëse ky rikualifikim lirues për vrasjen e Almirit konfirmohet edhe nga gjykata, Maqedoninë e pret edhe një padi e re- para Gjykatës së Strasburgut.

Vrasja e Almirit, pra, nuk është vetëm tragjedi familjare. Është vrasje e shoqërisë që pas kapjes 11 vjeçare, premtoi drejtësi të verbër: të bazuarit vetëm në fakte objektive dhe jo në interpretimin e tyre subjektiv. Aq sa është humbje për familjarët, jeta e shuar me dhunë e Almirit, tërheq po aq edhe vijën e kuqe- poshtë të cilës- nuk guxon të rrëshqet shteti. Sepse, pa gjyqësor të pavarur, nuk ka sundim të ligjit. Pa sundim të ligjit nuk ka drejtësi. Pa drejtësi nuk ka barazi të qytetarëve. E kjo e fundit nuk arrihet, kur të gjithë prokurorët e një

etnie, e ri-kualifikojnë vrasjen me paramendim- në "aksident trafik"; pas të cilës vrasësi krekoset triumfalisht; e mjeti i vrasjes-qarkullon rrugëve lirisht.

Nuk ka drejtësi kur ajo vendoset me mbivotim gishtash, e me ngritjen e gishtit të mesëm të vrasësit, që vetëm ri-konfirmon paramendimin; aspak pendimin për shuarjen e një jete fëmijë.

Nuk dua ti besoj teorive të konspiracionit, e as skenarit balancues, që lidh lirimin e vrasësit të Almirit si amortizues për votimin e "Ligjit për gjuhët". Aq më pak dua të besoj, se skandali i ish-kryeministrit atë ditë në Parlament, ishte përpjekje për reprizimin e 27 prillit. Sikur që nuk dua të besoj se paralajmërimi i partisë më të madhe opozitare maqedonase për protesta masive në vend, është përpjekje për të bllokuar - jo vetëm çështjen e fundit të pa implementuar të Marrëveshjes së Ohrit, por edhe atë të kontestit me Greqinë për emrin- si parakusht për hyrje në NATO.

Fundja, nuk dua të besoj, as se fuqia botërore, që kundërshton anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, do i gëzohej trazirave poli-

Të humbur pas "çështjeve të mëdha kombëtare", po harrojmë se para syve po gjakosin fatet e thjeshta njerëzore. Vërtet, për një shtet është me rëndësi orientimi i tij strategjik, por për një familje shumë më me rëndësi është të mos përsëriten tragjeditë e reja si ajo e Almirit



tike vendore- tre muaj para samitit, ku vendi pritët të bëhet anëtarja e 30-të e Aleancës Veri- Atlantike. Shumë spekulime e tepër skenarë të mëdha, për një vend të vogël, por kyç për sigurinë rajonale. Të gjithë merren me politikë të madhe e harrojnë se jeta zhvillohet brenda politikave të vogla. Të humbur pas "çështjeve të mëdha kombëtare", po harrojmë se para syve po gjakosin fatet e thjeshta njerëzore. Vërtet, për një shtet është me rëndësi orientimi i tij strategjik, por për një familje shumë më me rëndësi është të mos përsëriten tragjeditë e reja si ajo e Almirit. Epilogu i pardjeshëm lirues i të dënuarve të pafajshëm të rastit të Sopotit, është edhe një provë më tepër se çfarë gjyqësori nuk do të duhej të kishte Maqedonia.

Gjykimi i ndërgjegjes, shpresoj se do peshoj më tepër se gjykimi politik tek gjykata, e cila duhet ta hedh poshtë diktatin rikualifikues prokurorial. Gjykata franceze, para më shumë se një shekulli, kishte liruar një të dënuar të pafajshëm, duke ri-kthyer drejtësinë. Kjo e jona, sot, duhet ta dënoj fajtorin e liruar, duke ri-vendosur barazinë ligjore.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)



Nga Blerim REKA

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 20 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
 Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
 E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
 Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

ALMIRI, simboli i një shteti që po e vrasim



Nga Bilal KASAMI

Në Maqedoni, në vazhdimësi është derdhur gjaku i shqiptarëve të pafajshëm të të gjitha moshave, që nga themelimi i saj e deri në ditët e sotme. Por, rasti i Almiri është rasti më tipik i ndërlidhjes së fatit të shqiptarëve me atë të shtetit.

Tanimë, gjithnjë e më të shumtë janë zërat se Maqedonia po rilind si një shtet i ri, një shtet ku edhe shqiptarët po faktORIZOHEN si një popull shtetndërtues. Edhe përkundër faktit se kemi një emigrim të popullsisë shqiptare, që në momente mund të llogaritet edhe shqetësues, përsëri trendet demografike janë në favor të shqiptarëve. Shqiptarët, me një popullsi të re dhe me tre universitete në gjuhën amtare, padysim se janë e ardhmja e këtij shteti.

Për më shumë, maqedonasve ju ndodh ajo që i ndodh çdokujt që ballafaqohet me një fobi të caktuar. Ashtu sikurse edhe individit kur ballafaqohet me një situatë fobie e humb racion dhe rrjedhimisht edhe kontrollin mbi vetveten dhe veprimet e tij, edhe maqedonasit më mirë se vetë shqiptarët e kanë kuptuar se e ardhmja e Maqedonisë është vetëm me shqiptarë të barabartë, por këtë ende nuk janë të gatshëm ta pranojnë.

Vrasja e Almiri ka ndodhur në situatë të një konflikti në mes të familjes së tij dhe vrasësit dhe jo rastësisht personat e përfshirë në këtë konflikt ju përkasin etnive të ndryshme. Ballafaquar me një realitet të pamohueshëm se vrasja ka ndodhur me paramendim, si rezultat i një sulmi me veturë ndaj familjes së Almiri nga ana e vrasësit, pas një konflikti paraprakë verbal. Në kushtet kur gati se i gjithë opinioni vendës i ka parë më shumë se një herë pamjet filmike të vrasjes së këtij vogëlushi, prokurori i ri, i cili u votua në parlament edhe nga disa shqiptarë dhe i cili duhej të kishte prioritet rikthimin e besimit të institucioni që drejton, ai bëri një veprim që jo vetëm se e vrau Almirin për herë të dytë, por u kujdes që me veprimin e tij t'i jap edhe goditjen e radhës të ardhmes së Maqedonisë.

Ashtu si edhe vrasja e Almiri, edhe vrasja e Maqedonisë po ndodh me paramendim. Derisa vrasja fizike e Almiri ka ndodhur nga një person dhe në kushte kur duhej të veprojnë institucionet për të vënë drejtësinë në vend, ndodhi edhe vrasja e dytë e këtij vogëlushi të pafajshëm. Ngjashëm edhe me rastin e Maqedoni-



së, përderisa prokurori si individ mund edhe të ketë bindje raciste ndaj shqiptarëve, me çka duke keqpërdorur një institucion kaq të rëndësishëm po vret besimin e qytetarëve, janë institucionet e tjera të shtetit ata që po e vrasin të ardhmen e Maqedonisë, me përkrahjen në heshtje të një veprimi të tillë nga ana e prokurorit.

Dhe mesazhi është më se i qartë. Shqiptarët janë të padëshiruar në institucionet e shtetit që drejtohen nga maqedonasit dhe ata duhet vepruar ngjashëm si edhe në rastet e tjera që nuk janë të pakta. Këtu do të përmend vetëm një, që e vlerësoj të rëndësishëm për të ardhmen e Maqedonisë. Në vitet e nëntëdhjeta, që nga pavarësimi i Maqedonisë, menjëherë shqiptarët u çuan në këmbë që të kërkojnë një të drejtë që me të gjitha konventat ndërkombëtare llogaritet si e drejtë elementare njerëzore, të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare. Atëherë, kur pritej një përkrahje nga bashkëqytetarët e etnitetit maqedonas për një kërkesë kaq fisnike, ne u ballafaquam me të rinj, të mbështetur edhe nga profesorët e tyre, që protestonin kundër shkollimit të shqiptarëve në gjuhën e tyre amtare.

Atëbotë, ashtu si sot, qasja e maqedonasve edhe si qytetarë, por edhe si bartës të institucioneve shtetërore ishte dhe mbeti qasje antishtetërore. Një qasje shtetërore do të nënkuptonte që në

ballë të kërkesës së shqiptarëve për shkollim në gjuhën amtare duhej të qëndronin maqedonasit, kurse institucionet e shkollimit të lartë do të duhej që t'i hapnin dyert dhe t'i prisnin krah hapur të rinjtë shqiptarë. Me këtë do t'u mundësonin shqiptarëve shkollim në gjuhën amtare, duke studiuar në ambiente të përbashkëta me kushte të barabarta me moshatarët e tyre maqedonas. Njëherësh, do të studionin në programe të njëjta dhe për një shtet që të gjithë do ta ndjenin si të vetin, pa marrë parasysh dallimet etnike.

Por, kjo nuk ndodhi. A thua vallë maqedonasit me rezistencën e tyre ia arritën që t'ua mohojnë shqiptarëve të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare. Sigurisht që jo. Sot, njëzet vite më vonë shqiptarët kanë hiç më pak se tre universitete në gjuhën amtare. Por vallë a mësojnë me të njëjtat programe studimore si moshatarët e tyre maqedonas? A mësojnë për një Maqedoni të njëjtë si moshatarët e tyre maqedonas? A mësojnë me kushte të njëjta si moshatarët e tyre maqedonas? Sigurisht që përgjigja në këto dhe shumë pyetje të tjera të kësaj natyre është një JO e madhe. Tanimë shqiptarët mësojnë për një Maqedoni që duhet ndërtuar nga fillimi si një shtet edhe i tyre po aq sa i maqedonasve. Një Maqedoni që shpejt do të duhet të flasë edhe shqip, sepse këta studentë të sotëm, burrështetas të së ne-

sërmes, as që e ndejnë nevojën dhe më së paku e kanë dëshirën që të mësojnë gjuhën e bashkëqytetarëve të tyre maqedonas. Njëjtë siç kanë vepruar moshatarët e tyre maqedonas me dekada të tëra, duke jetuar me shqiptarët dhe duke mos mësuar edhe gjuhën e tyre.

Dhe sot, me rastin e vrasjes së Almiri, shqiptarët marrin mësimin e radhës nga bashkëqytetarët e tyre maqedonas. Almiri po bëhet kurban i një sistemi të drejtësisë që duhet ndërtuar nga vetë ata edhe përkundër rezistencës së maqedonasve, ashtu si Abdyse-lam Emiri që u bë kurban i arsimit të lartë në gjuhën shqipe dikur. Reagimi i katër prokurorëve shqiptarë dhe e gjithë ajo që do të pasojë mund të jenë vetëm hapja e kutisë së Pandorës.

Sa më parë që maqedonasit e pranojnë se detyrimisht shqiptarët po ndërtojnë të ardhmen e tyre si të barabartë në këtë shtet të përbashkët, aq më mirë do të bëhet për të gjithë ne, pa marrë parasysh cilës përkatësi i takojmë. Si në rastin e shkollimit në gjuhën shqipe edhe sot, o do të ketë sistem të drejtësisë që do të ndajë drejtësi edhe për shqiptarët, as më pak e as më shumë po njëjtë si për maqedonasit, ose shqiptarët do fillojnë me themelimin e gjykatave dhe prokurorive të tyre, sado që kjo sot mund të duket diçka absurde.

Por, rasti i Almiri edhe një herë po tregon se maqedonasit që moti kanë ngritur duart nga Maqedonia si një shtet i përbashkët me shqiptarët. Ata me veprimet e tyre, si individuale por edhe institucionale, po e vrasin Maqedoninë vetëm pse duhet të jetë edhe shqiptare, ashtu si e vranë edhe Almirin vetëm pse ishte shqiptar.

Pra, Almiri le të jetë simboli i një ndërgjegje të kthjelluar individuale dhe institucionale të maqedonasve që përfundimisht të ulen me shqiptarët e të merren vesh se pajtohen që të ndërtojmë këtë shtet të barabartë. Një Maqedoni që do të ketë një identitet të ri, pse jo edhe emër të ri, dhe emri i Almiri do të ishte një emër që do të duhej ta mbaj me nderë edhe shteti. Një emër që gjithmonë do të na përkujtonte të gjithëve se sa afër ishim që t'i lejojmë maqedonasit që ta vrasin shtetin, vetëm se po ballafaqohen me fobinë e tyre se shqiptarët po jua marrin atë.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Rasti i Almiri edhe një herë po tregon se maqedonasit që moti kanë ngritur duart nga Maqedonia si një shtet i përbashkët me shqiptarët. Ata me veprimet e tyre, si individuale por edhe institucionale, po e vrasin Maqedoninë vetëm pse duhet të jetë edhe shqiptare, ashtu si e vranë edhe Almirin vetëm pse ishte shqiptar



GADAF REXHEPI, PROFESOR UNIVERSITAR

KUR DËSHTON**ME ARSIMIN,****DËSHTON****GJITHANDEJ**

Për të nxitur optimizmin, ne duhet të punojmë të nxisim sipërmarrësinë dhe për të arritur përqindje më të lartë të ndërmarrjeve me pronarë shqiptarë në Top 10 apo edhe 100 kompanitë më të mira në Maqedoni na duhen kuadro shumë cilësorë në të gjitha profilet. Për të realizuar këtë fillimisht duhet të krijojmë shkolla filllore dhe të mesme, të cilat do të jenë në top shkollat më të mira dhe jo shkollat tona të jenë të ranguar në fund. Ngjashëm është situata dhe me universitetet ku ne kemi krijuar tre universitete, të cilat kanë filluar të krahasohen mes veti duke harruar se ne jetojmë së bashku me nacionalitete tjera, dhe duke penguar njëri-tjetrin dhe duke garuar se kush na qenka më i miri tek shqiptarët

Koha

Delvina KËRLUKU

Gadaf Rexhepi ka lindur në Shkup, shkollën filllore në "25 Maji", të mesmen ekonomike "Arseni Jovkov". Tre ciklet e shkollimit të lartë në Fakultetin Ekonomik "Shën Kirili dhe Metodi", ndërsa pjesë të studimeve të doktoratës i ka realizuar në "Wolverhampton University", në Angli. Nga viti 2003 është pjesë e Universitetit të Evropës Juglindore si ligjërues në lëndët "Principet e Menaxhmentit", "Menaxhmenti Strategjik" dhe "Teoria e Lojës". Ai ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare mes të cilave në Universitetin e Oksfordit dhe Kembrixhit, Universitetin e Grazit, si dhe në shumë universitete tjera në Belgjikë, Angli, Austri, Turqi, Kroaci, Slloveni, Moldavi, Romani, Greqi, etj. Ai është autor dhe bashkautor i disa librave të botuara në shqip, por dhe në anglisht nga shtëpi botuese më me renome si Routledge, Springer dhe Taylor and Francis ku dhe në një libër "Routledge Handbook of Social Finance" është bashkautor me disa profesorë nga Universiteti i Kembrixhit dhe Oksfordit. Ajo që më shumë bie në sy janë mbi 50 punime shkencore të botuara në disa nga revistat dhe shtëpitë botuese më me renome në botë një pjesë e tyre të listuara në web of science (me faktor ndikimi). Ai së bashku me dy bashkautor tjerë ka qenë fitues i punimit shkencor më të mirë për vitin 2016 nga EMERALD. Ga-

daf Rexhepi është i martuar dhe ka një djalë.

KOHA: Qeveria e re e Maqedonisë parashikon më shumë investime këtë vit dhe ripërtëritje të ekonomisë, sidomos pas rënies që pësoi vitin e kaluar si pasojë e krizës politike. Sa optimist jeni në përmirësimin dhe zhvillimin e ekonomisë në vend?

REXHEPI: Pas një krize të thellë politike që gjithsesi ndikoi shumë dhe në pjesën ekonomike, mendoj se optimizmi ishte evident tek të gjithë qytetarët në Maqedoni. Kur kemi kështu situata, pra optimizëm më të lartë nga konsumuesit e produkteve dhe shfrytëzuesit e shërbimeve, më bën të mendoj se mund të kemi një përmirësim të gjendjes së përgjithshme ekonomike. Por, kjo personalisht nuk më gëzon dhe shumë, pasi që mendoj se Maqedonia nuk ka nevojë për përmirësime të vogla, por për zhvillim real të ekonomisë së vendit dhe në këtë pjesë - optimizmi im është i ulët. Në situata kur nuk ka turbulenca, ekonomitë në mënyrë të natyrshme kanë rritje ekonomike (nga 1 - 2 për qind rritje të GDP-së), por ajo çka ne si ekonomi kemi nevojë është zhvillim real i ekonomisë (5 - 6 përqindje rritje të GDP-së). Po e cek zhvillim real pasi që edhe në situatë të kemi rritje ekonomike prej 5 - 6 për qind edhe për disa vite kjo nuk do të thotë që të gjithë qytetarët do të e ndiejnë këtë zhvillim njëjtë pra me rëndësi është dhe di-

tribuimi i rritjes ekonomike. Të analizojmë këtë përmes një shembulli, 5 vitet e fundit kemi patur një rritje ekonomike që duket diçka pozitive por kjo ka qenë kryesisht si rezultat i investimeve të mëdha në fushën e ndërtimitarisë (Shkupi 2014) kjo nënkupton që rritjen e kanë ndje kryesisht ndërmarrjet në sektorin e ndërtimitarisë por jo dhe sektorët tjerë. Por, edhe në sektorin e ndërtimitarisë duke patur parasysh që këta projekte i kanë realizuar vetëm disa firma do të thotë se jo të gjitha firmat në këtë sektor e kanë ndje këtë zhvillim. Gjithashtu, dhe nëse kemi parasysh se rroga e të punësuarve në këto ndërmarrje nuk është rritur në mënyrë drastike, besoj është e qartë që efekti i kësaj rritje ekonomike është ndjerë vetëm tek një grup shumë i vogël njerëzish apo ndërmarrje. Kjo është dhe arsyeja pse shumica e qytetarëve sot janë më të palumtur në krahasim me të kaluarën edhe pse shikuar numrat ne kryesisht qëndrojmë më mirë (para 10 viteve papunësia ka qenë rreth 33 për qind ndërsa, sot është 24 për qind, GDP për capita është rritur rreth 1000 dollarë, rroga mesatare gjithashtu ka patur rritje prej rreth 6000 denarë). Pra rritja ekonomike pa ndonjë zhvillim real ekonomik nuk është edhe ndonjë parametër matës shumë i mirë. Në mesin e shumë ekonomistëve në shumë shtete, shpesh diskutohet se zhvillimi ekonomik i shtetit nuk duhet të matet vetëm me GDP-

në, por dhe me shumë parametra tjerë, të cilat janë të lidhura direkt me qytetarët dhe me atë sa ata ndiejnë ndryshime cilësore në përditshmërinë e tyre. Mendoj se dhe kjo qeveri duhet të jetë e orientuar në zhvillim ekonomik dhe jo vetëm në rritje ekonomike.

KOHA: Stabilizimi i situatës politike dhe kthimi i besimit të investitorëve do të ndikojë edhe në rritjen e lëvizjeve ekonomike private. Kjo ka munguar vitet e kaluara!? Për të mundësuar një gjë të tillë, a duhet vetëm mbështetje buxhetore?

REXHEPI: Bizneset kanë nevojë për përkrahje qeveritare, por duhet të kemi të qartë se përkrahja e tyre duhet të jetë në formë të ndryshme varësisht nga faza e zhvillimit të ndërmarrjes. Pra, nëse një ndërmarrje funksionon suksesshëm vite me radhë - mund të përkrahët duke i lehtësuar ndonjë procedurë burokratike, përkrahja financiare duhet të orientohet të bizneset e reja që janë në fazën fillestare të biznesit, por kryesisht në financimin e biznes ideve apo inovacioneve tek të rinjtë dhe dhënie e "knoë-hoë" apo dijeve profesionale në fazat e para të zhvillimit të biznes ideve. Kjo fatkeqësisht po bëhet kryesisht vetëm për të patur në agjendë, por jo dhe realisht. Do të kisha patur shumë dëshirë që një ditë të shoh shumicën e të rinjve, të cilët janë të orientuar në krijimin e ndonjë ideje

biznesore dhe më pak shndërrim të kësaj ideje në inovacion përmes procesit të komercializimit. Kreativiteti nuk është se mungon, por mungon orientimi dhe përkrahja. Për atë arsye mendoj se përkrahja qeveritare mundem mjaft të ndikon dhe se ajo është çdoherë e nevojshme.

KOHA: Edhe pse një pjesë e konsiderueshme e biznesit kanë të holla edhe ide për investime, megjithatë ato janë në pritje se çka do të ndodhë në të ardhmen me ambientin politik në vend. Si mendoni, cilat janë barrierat e sipërmarrjes në biznesin aktual?

REXHEPI: Fillimisht dua të cek që në Maqedoni na mungojnë, do t'i quaj sipërmarrës të vërtet, ato mendoj se janë shumë të pakët. Tek ne, sidomos në pjesën e bizneseve shqiptare, si formë më e zhvilluar biznesi është tregtia. Tregtia edhe pse edhe ka rëndësinë e vet - për çdo ekonomi ajo paraqet formën më të thjeshtë të bërjes biznes, dhe efekti i saj në ekonomi zakonisht është shumë i ulët. Ajo që bie në sy sidomos tek ndërmarrjet që merren me tregti që ata tregun e shohin si "zero-sum game", apo që të fiton njëri duhet tjetri të humbë dhe fatkeqësisht dhe investimet e tyre i orientojnë në biznese që realisht kjo dhe vlen. Pra, investitorët e ri kryesisht po orientohen në tregjet ku kemi shumë ndërmarrje që ofrojnë produkte apo shërbime. Ata,

për të tërhequr klientë të rinj, po ulin çmimet dhe më pas dhe cilësinë e vet punës në përgjithësi. Do të kisha rekomanduar që sipërmarrësit e rinj të mundohen të kuptojnë tregun si "non-zero sum game", pra nëse vjen me produkt apo shërbim inovativ apo nëse vendos të shesësh në ndonjë treg të ri, nuk ka nevojë patjetër të marrësh një klient nga dikush tjetër (krijë treg të ri). Në kontekst të barrierave nuk besoj se ka vend që nuk ka barriera por, natyra e tyre dallon, këshu në Maqedoni mendoj se janë disa barriera si krizat politike, ndarja e tenderëve në forma jo-transparente, korrupsioni, ekonomia jo-lojale, fuqia blerëse e konsumatorëve etj.

KOHA: Ligji për zhvillimin e barabartë rajonal shumë pak ka arritur të sigurojë një nga qëllimet e tij, atë të zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm në tërë territorin e Maqedonisë. Cila është mundësia për zvogëlimin e pabarazive ndërmjet dhe në kuadër të rajoneve të planit, shfrytëzimit optimal dhe valorizimit të pasurisë natyrore, kapitalit njerëzor dhe veçorive ekonomike të rajoneve të ndryshme, ringjalljes së fshatrave dhe zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, etj?

REXHEPI: Tentativa për zhvillim të barabartë rajonal në vitet e kaluara ka patur, por ato kanë qenë shumë jo-efikase. Sot Shkupi është thujse gjysma e Maqedonisë, por jo rastësisht kjo për shkak të mundësive më të mëdha për punësim si dhe infrastrukturës më të mirë. Sot kemi qytete siç është Dibra me një rini shumë të shkolluar dhe qytetarë të tillë, por që fatkeqësisht është thujse i zbratur. Kërçova, Gostivari dhe Tetova në masë të madhe ndihmohen nga familjarët e tyre në mërgim që është e pakuptimtë sidomos nëse shihet gjithë ato resurse natyrore në këto anë ku nuk investohet aspak. Mund të merrni si shembull Kodrën e Diellit, e cila është lënë pas dore edhe pas kërkesave për investime në këtë vend. Gjendja e saj akoma vazhdon të jetë në gjendje siç edhe është. Qeveria e Maqedonisë hapi Zona të lira duke orientuar investimet në disa rajone të ndryshme, por duke lënë anash rajonet shqiptare. Nëse analizoni Zonat e lira ekonomike në gjithë Maqedoninë, do të habiteni sa pak shqiptarë janë të punësuar këtu. Mos të flasim për Kumanovën apo zonën e Likovës, e cila është lënë totalisht në harresë, dhe pikërisht ajo zonë ka një potencial të jashtëzakonshëm dhe një kërkesë të madhe nga njerëzit të vizitojnë këto vende. Pra, është e pa kuptimtë si shteti nuk arriti të investon në këto potenciale, por dhe shumë tjera kur kërkesa për të vizituar këto vende është shumë e madhe. Mos të flasim për infrastrukturën e sidomos shkollat ku ata mësojnë. Fshatrat, sidomos të rajoneve jashtë Shkupit, janë në gjendje të mjerueshme.

KOHA: Problem tjetër që mundon jo vetëm Maqedoninë, por edhe shtetet e rajonit - është ikja e madhe jashtë shtetit e pjesës me vitale të popullatës. Vetëm nga Maqedonia llogaritet se kanë ikur me qindra

mijëra të rinj vetëm në 10-15 vitet e fundit. Ku e shihni këtë ngërç të problemit?

REXHEPI: Përkrah natalitetit shumë të ulët dhe mplakja e shpejt e qytetarëve të shtetit, problem tjetër serioz është largimi i të rinjve. Në të kaluarën, sidomos shqiptarët kishin emigrim të lartë që edhe pse edhe ky proces nuk ka qenë i mirë në aspektin ekonomik ka dhënë disa efekte pozitive, për faktin që shumica e këtyre individëve ishin kryesisht njerëz me shkollim dhe kualifikime shumë të ulëta dhe kryesisht nga fshatra pa perspektivë. Pra nga aspekti ekonomik janë larguar njerëz që kanë patur problem për ekonominë (nuk dua të ndërhyj në pjesën pse veç tek shqiptarët) që në afat të gjatë edhe kjo është një problem serioz për shtetin dhe ekonominë. Por, sot gjendja është edhe më e keqe pasi që tani nga Maqedonia largohen disa nga të rinjtë, të cilat janë me arsimin shumë të lartë dhe kanë kualifikime të shkëlqyera. Kjo është situatë që ndikon shumë negativisht në ekonominë tonë, e sidomos pas disa viteve jam i bindur se kjo do të reflektohet edhe më shumë. Kjo për faktin që këta të rinj kanë kapacitet të jenë bartës të proceseve të reja nëpër ndërmarrjet ekzistuese, kanë kapacitet të krijojnë inovacione për të krijuar ndërmarrje të reja, të cilat do të jenë në gjendje të shesin produkte apo shërbime në tregun ndërkombëtar, të jenë mjekë të shkëlqyer etj. Si problem më serioz për moment kemi largimin e mjekëve të rinj që erdh vetëm pas një liberalizimi të tregut në Gjermani, por mos të harrojmë që me integrimin në BE mundësitë e tyre do të jenë edhe më të mëdha atëherë ky problem mund të jetë më i madh. Arsyet pse ndodhin janë të shumta, por fillimisht mendoj se lidhen me mospasjen e mundësisë të punësimit të menjëherëshëm, rrogat shumë të ulëta, kushtet

e punës, mundësia për progres në punë, mosrespekti, padrejtësitë në punë etj. Një moment tjetër që mendoj se gjithashtu ka ndikim është krijimi i një perceptimi që më të mirët çdoherë largohen se ata më të dobët ngelin këtu, apo glorifikimin e atyre që kanë arritur ndonjë rezultat shumë mesatar në ndonjë vend pune në ndonjë shtet perëndimor duke anashkalluar kuadrot që kanë vendosur të qëndrojnë këtu. Mendoj se mediat duhet të promovojnë edhe vlerat e atyre që kanë vendosur të qëndrojnë në Maqedoni edhe përsëri mundësive që edhe ata i kanë, mendoj se këta janë heronjtë e vërtet. Nuk dua të uli vlerën a atyre që kanë vendosur të largohen dhe që kanë arritur të sistemohen mirë - gjithsesi kjo është një e arritur për respekt. Por si shoqëri, duhet të kuptojmë se sot nuk është ndonjë e arritur spektakulare që një i ri të punon në ndonjë universitet, spital apo institucion tjetër në ndonjë shtet perëndimor. Qeveritë duhet të kuptojnë që mundësitë e këtyre të rinjve dallojnë edhe nga ato para 10 viteve e mos të flasim para 20 e më shumë viteve. Për të punuar mjek, inxhinier apo edhe programer në ndonjë shtet të Unionit Evropian ka qenë thujse e pamundur, por sot kjo nuk është ashtu. Andaj, ata duhet të kuptojnë që kostot oportune për një të ri për të qëndruar në vendlindje janë shumë më të larta, për shkak mundësive që kanë. Nëse ne nuk mësohemi ti respektojmë vlerat më shumë, por dhe të përkujdesemi për ata jam i bindur se ky trend do të vazhdon.

KOHA: Një sfidë shqiptare është dhe struktura ekonomike ende e dobët. Nga buron optimizmi për perspektivën e tyre ekonomike?

REXHEPI: Fatkeqësisht, edhe pse ka patur mjaft ndryshim të gjendjes së shqiptarëve në Maqedoni mendoj

se ne jemi akoma në situatë shumë të rëndë. Nëse analizojmë 10 ndërmarrjet më të mëdha në Maqedoni, asnjë nuk është me pronar shqiptar, por dhe në 100 ndërmarrjet më të mëdha dhe me të suksesshme në Maqedoni - bizneset me pronarë shqiptarë sillen zakonisht rreth 6-7 për qind. Kjo po që është një problem serioz që reflektohet në faktin se pse shumica e të rinjve shqiptar nuk arrijnë të punësohet dhe se shumica atakojnë administratën shtetërore.

Një pjesë e madhe e shqiptarëve jetojnë në kushte shumë të rënda, por jo vetëm që kanë probleme me gjendjen ekonomike brenda në shtëpi, por dhe në vendet ku ata jetojnë, shkollat ku mësojnë, çerdhet, spitalet, rrugët, kanalizimet, kaosi në urbanizim si dhe kaosi në rrugë. Gjithsesi, një fëmijë i rritur në këto kushte do të jetë nxënës më i dobët, nuk do të ketë kreativitet, do të jetë më i padisciplinuar si dhe shumë anomali tjera në krahasim me nxënës që i kanë këto kushte (shumica e nxënësve maqedonas). Sipas një hulumtimi të bërë që si duket do të shpallet shpejt, fëmijët shqiptarë në krahasim me ata maqedonas del të jenë shumë më të dobët, fakt që nuk besoj se do të na befason pasi që duke u nis nga ajo që cekam më herët është gjithsesi i pritshëm. Moment tjetër është që vdekshmëria e foshnjave të gratë shqiptare është shumë më i lartë se tek ata maqedonas, si dhe e fundit - nëse shohim numrat e amnistisë së fundit të burgosurve, vërejmë që numri i shqiptarëve dhe maqedonasve ishte thujse i barabartë. Kjo jo për faktin që shteti jonë është reformuar deri në atë pikë, por pasi që numri i shqiptarëve në burgje si përqindje është shumë më i lartë se të tjerët. Po i cekim këto fakte pasi që nëse ne jetojmë në këto rrethana nuk mund të presim që të nxisim sipërmarrësinë apo suksesin tek të rinjtë shqiptar sidomos jo në nivel të atyre maqedonas. Po ju jap dhe një fakt! Nga katër konkurse nga fondi i inovacionit për financim të start-up të ri, ka patur vetëm një aplikant shqiptar, ndërsa për çdo konkurs ka patur mesatarisht rreth 50 aplikantë gjithsej (pronarë maqedonas). Maqedonia si shtet po vazhdon të tregohet e padrejtë ndaj shqiptarëve dhe ne si duket nuk po arrijmë të vërejmë këto pasi jemi koncentruar në çështje tjera. Për të nxitur optimizmin, ne duhet të punojmë të nxisim sipërmarrësinë dhe për të arritur përqindje më të lartë të ndërmarrjeve me pronarë shqiptarë në Top 10 apo edhe 100 kompanitë më të mira në Maqedoni na duhen kuadro shumë cilësorë në të gjitha profilet. Për të realizuar këtë fillimisht duhet të krijojmë shkolla fillore dhe të mesme, të cilat do të jenë në top shkollat më të mira dhe jo shkollat tona të jenë të ranguara në fund. Ngjashëm është situata dhe me universitetet ku ne kemi krijuar tre universitete, të cilat kanë filluar të krahasohen mes veti duke harruar se ne jetojmë së bashku me nacionalitetet tjera, dhe duke penguar njëri-tjetrin dhe duke garuar se kush na qenka më i miri tek shqiptarët. Kjo për mua flet se jemi duke lëvizur pa vizion sado që mendojmë se e kemi atë.

KOHA: Duke patur parasysh se jeni profesor universitar, bashkëshort dhe prind, si e përshkruani ciklin e jetës tuaj?

REXHEPI: Në universitetin e Evropës Juglindore (Shtuli) kam filluar të punoj thujse menjëherë pas diplomimit si asistent i ri, mandej duke kaluar nga asistenti në docent dhe tani profesor i asociuar. Janë diku 14 vite në Universitet dhe gjithsesi janë vitet më të bukura dhe më frytdhënëse. Universiteti i Evropës Juglindore ka qenë një vend që çdoherë ka ndihmuar kuadrot e reja dhe i ka përkrahur ato në çdo sfidë profesionale. Ne kemi arritur të evoluojmë shumë në krahasim me fillimet tona e kam fjalën për evoulim shumë të madhe dhe mendoj se stafi i këtij universiteti është vërtet konkurrues me shumë universitet që ekzistojnë në Maqedoni dhe rajon.

Fatkeqësisht, politika e arsimit të lartë ka ndikuar tek të gjitha universitetet duke mos i lejuar ata të zhvillohen në formën e duhur. Çdo herë kur dal para studentëve ndjej një kënaqësi të jashtëzakonshme dhe jam shumë i lumtur që kam mundësinë të përçoj njohuri tek studentët. Por gjithsesi të gjitha këto lëvizje në karrierë në periudha të ndryshme kanë kërkuar kohë dhe përkrahje që asnjëherë nuk më ka munguar si nga prindërit deri në përfundimin e studimeve të mia dhe me pas dhe nga bashkëshortja ime. Mendoj se është shumë me rendësi të bëhet një kompromis mes karrierës dhe jetës private, asnjëherë nuk kam menduar se me qëllim të arrijtes në karrierë të sakrifkohet familja apo jeta private.

Gjithsesi se ka periudha në jetë sidomos gjatë studimeve kur kemi nevojë të sakrifikojmë më shumë dhe si primare kam patur mësimin por pas përfundimit të të gjitha niveleve të studimeve shumë herë kam bërë (ende bëj) sakrificat profesionale duke refuzuar shumë mundësi të cilat ndoshta do të më kishin vendosur në pika edhe më të larta profesionale sidomos ato ndërkombëtare por shumë pak herë kam bërë sakrificat të tepruara familjare.

Me bashkëshorten time, e cila ka qenë studente në Fakultetin e Mjekësisë thujse çdo ditë kemi gjetur mënyre të shihemi dhe pimë kafe bashkërisht. Për mua ka qenë ndihmëse e madhe ky kompromis pasi që përmeshja shpirtërore në shtëpi më bën të jem më i qetë dhe i koncentruar në punë.

KOHA: Ku e bashkon dhe e dalton dashurinë tuaj mes familjes dhe universitetit?

REXHEPI: Gjithsesi se bëhet fjalë për kënaqësi të ndryshme, por ato janë komplementare. Mendoj se njeriu ka nevojë për dashuri dhe përmeshje profesionale por dhe për nevojë për dashuri dhe përmeshje familjare.

Çdo ditë i gëzohem fatit që kam një punë që vërtet e dua dhe më përmesh, por dhe një bashkëshorte dhe familje me të cilën arrijmë që thujse çdo ditë ta shndërrojmë në të jashtëzakonshme. Tani kemi dhe djalin tonë, Kroni, që vetëm se e ka bërë jetën tonë edhe më të bukur.



Dërgesat nga diaspora, në Kosovë vazhdojnë të paraqesin një prej burimeve kryesore të financimit të konsumit të ekonomive familjare. Po ashtu, ato paraqesin burime që sigurojnë gjendje stabile sociale.

Sipas të dhënave të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës dërguar Radios Evropa e Lirë, remitencat vazhdojnë të shënojnë rritje. Shuma e remitencave në vitin 2017 ishte 759.2 milionë euro, derisa në vitin 2016 ishin 691 milionë euro.

Remitencat që pranohen në Kosovë kryesisht vijnë nga Gjermania, Zvicra, SHBA-ja, Italia, Suedia, Austria, Franca, Britania e Madhe dhe shtete të tjera.

Përveç remitencave që dërgohen vazhdimisht në Kosovë, shumta të mëdha të mjeteve financiare emigrantët nga Kosova shpenzojnë edhe kur vijnë për pushime, sidomos gjatë stinës së verës.

Janë kushtet e rënda socio-ekonomike në Kosovë që kanë obliguar emigrantët t'u dërgojnë para familjeve të tyre.

Bajram Thaçi jeton në Gjermani. Ai thotë se ka ndihmuar për vite me radhë familjarët e tij Kosovë.

"Po, ata kanë pasur nevojë për ne dhe iu kemi ndihmuar. Disa prej tyre kanë qenë pa punë dhe kanë pasur nevojë për neve. Tani, disa edhe janë punësuar dhe më nuk kanë nevojë për parat tona", thotë

MËRGIMTARËT VAZHDOJNË TA MBAJNË KOSOVËN

SHTOHEN REMITENCAT



ai për Radion Evropa e Lirë.

Ndërsa, Astrit Kastrati thotë se pa mbështetjen e familjarëve të tyre nuk do të arrinin të ja dilnin me pagat që marrin në Kosovë.

"Kam shumë familjarë jashtë vendit. Ata na ndihmojnë mua më kanë ndihmuar për studimet e mia kanë paguar të gjitha çfarë kam pasur nevojë, fakultetin, banesën ku jetojmë me qira, të gjitha. Por, kur të punësohem do ta mbaj veten dhe nuk do të pres paratë e tyre. Unë ju jam falënderues për të gjithë që ata kanë bërë për neve këtu", thotë ai.

Kosova konsiderohet si një ndër shtetet që pranon më së shumti dërgesa nga diaspora, apo emigrantët e saj që jetojnë në vende të ndryshme.

Eksperti i çështjeve ekonomike

Mejdi Bektashi tha për Radion Evropa e Lirë se me liberalizimin e vizave, edhe remitencat do të shënonin rritje.

"Për vitin e ardhëm ose me liberalizimin më të shpejtë të vizave, ardhja e remitencave do të jetë edhe më e madhe, për shkak të mundësisë së qarkullimit më të lirë të qytetarëve të Kosovës, kryesisht të rinjve, që do të shkojnë edhe në shkollim edhe mund të punojnë punë të caktuara për të sjell remitencat në Kosovë. Besoj që nëse bëhet liberalizimi do të kemi rritje të remitencave, në të kundërtën do të kemi ngecje ose ngadalësim të ardhjes së remitencave në Kosovë", thotë Bektashi.

Sidoqoftë, sfiduese mbetet që mjetet e dërguara nga diaspora, të cilat shfrytëzohen më tepër për

konsum, të orientohen në investime që sjellin përfitime më të mëdha.

Qeveria e Kosovës kishte premtuar lehtësime për diasporën për hapjen dhe fillimin e bizneseve në Kosovë.

Sipas premtimeve nga Qeveria duhet të rritet pjesa e remitencave që dedikohet për investime, në mënyrë që të gjenerohen vende pune dhe zhvillim ekonomik, duke përfshirë sektorin e prodhimit, shërbimeve dhe të bizneseve familjare.

Nga rezultatet preliminare të regjistrimit të diasporës, numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës dhe botës, të cilët i janë përgjigjur regjistrimit, është rreth 350 mijë.



Kosova e Serbia, si Palestina e Izraeli?

Një përfaqësues i Ministrisë Gjermane të Punëve të Jashtme së shpejti do të mbërrijë në Beograd me një propozim për "zgjidhjen" e çështjes së Kosovës.

Sipas të përditshmes "Danas" Presidenti serb Aleksandar Vučić, ka thënë se Gjermania, përveç kërkesës tashmë të njohur që Beogradi dhe Prishtina të nënshkruajnë ligjin e detyrueshëm, kërkojnë që Kosova të marrë statusin e vëzhguesit të Kombeve të Bashkuara për fillim, raporton "Vestinet". Propozohet modeli i Palestinës për Prishtinën, i miratuar në vitin 2012 gjatë presidencës së Vuk Jeremiçiqit në Asambleenë e Përgjithshme të Organizatës Botërore. Berlioni (për momentin) nuk konsideron se Serbia duhet të njohë zyrtarisht një Kosovë të pavarur, por një veprim i tillë do të ishte një "zgjidhje e mirë", sepse Beogradi në fakt, por jo zyrtarisht, do ta njohë pavarësinë e krahinës së saj jugore. E gjithë kjo kohë e fundit u paraqit tek Vučić kur ai ishte mysafir i kancelares gjermane, Angela Merkel në Berlin.

XHANDARMËRIA SERBE FUTET NË TERRITORIN E KOSOVËS!



Ish kryetari i Kamenicës, Shaip Surdulli është shprehur i shqetësuar kur gjatë ditës së djeshme ka parë disa pjesëtarë të xhandarmërisë serbe duke patrulluar në territorin e Kosovës. Në një prononcim për IndeksOnline, Surdulli ka treguar se 8 pjesëtarë të ushtrisë serbe kanë qenë të uniformuar dhe me helmë në kokë dhe me armë të gjata teksa kanë patrulluar në brendi të territorit të Kosovës.

"Të dielën kah ora 13:30 duke ardhur nga mali kufiri me Serbi kaluan nëpër rrugën kryesore të lagjes së Bernjashëve ku edhe unë jetoj me familje në këtë lagje në drejtim të rrugës kryesore Novosellë-Karaçevë, një grup prej rreth 8 pjesëtarë të uniformuar, me helmë në kokë dhe me armë të gjata. N me një fqinjë, Baftjar Bernjashi ishim në oborrë të shtëpisë sime dhe menduam që këta pjesë-

tarë të ushtrisë janë të KFOR-it ukrainas të cilët ka pasur raste që kanë kaluar kësaj rruge deri sa KFOR-i Amerikan dhe ai Turk më shpesh e frekuentojnë këtë pjesë kufitare të Republikës së Kosovës me Serbinë. Më vonë erdhën me një veturë të Policisë së Kosovës tre police të vijes së gjelbert në lagjen tone dhe u shprehën të shqetësuar duke thënë se kanë qenë pjesëtarë të ushtrisë serbe sepse i

kane percjellur nga distanca se ata kane vazhduar deri diku afer rruges kryesore për Karaçeve të poshteme dhe janë krhyer për fshatin Breznice të Rep. së Serbisë, fshat i banuar me shqiptarë. Kurse dje kane ardhur ushtria amerikane dhe ajo Turke të KFOR-it me autobllinda dhe një helikopter të cilët e kane vëzhguar sikur edhe shpesh here tjera kete zone kufitare. Territori i kesaj lagje por edhe ne pergjithesi i Karaçevës nuk kontestohet qe eshte territor i Republikës së Kosoves, prandaj eshte shume skandaloze dhe e pa pranueshme nga banoret e kesaj lagje dhe ne pergjithesi e fshatit Karaçeve kalimi i ushtrisë serbe ne territor te Republikës së Kosoves. Kerkojme nga KFOR-i, por edhe nga Policia e Kosoves si dhe nga institucionet tjera te Republikës së Kosoves qe kjo kurr mos te perseritet sepse mund te kete pasoja ne pasigurine e banoreve", ka deklaruar Surdulli.



Gati për ndarjen e detit me Greqinë

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta ditën e djeshme ka dhënë plotfuqinë për të nisur negociatat me Greqinë në lidhje me detin. Mësohet se ka ndryshuar edhe grupi negociator i propozuar nga ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati. Grupit negociator mësohet se i është shtuar edhe juristi, Ksenofon Kristafi, i njohur në fushën e të Drejtës Ndërkombëtare.

Një biznesmen libanez, i identifikuar si Ziad Takieddine emri i të cilit doli gjatë hetimeve si ndërmjetës në dhjetra transaksione monetare mes Francës dhe vendeve të Lindjes së Mesme, ka rrëfyer para hetuesve në Paris se Sarkozy ka përfituar rreth 50 milion euro nga Gaddafi

Ish-presidenti i Francës, Nicolas Sarkozy është paraburgosur më 20 mars, si pjesë e një hetimi lidhur me financim të paligjshëm gjatë fushatës së tij më 2007 nga regjimi i diktatorit libian Muammar Gaddafi, raportojnë mediat.

Sarkozy është marrë në pyetje nga policia në stacionin në Nanterre, në perëndim të Parisit. Mediat kanë cituar burime brenda sistemit gjyqësor, të cilët kanë folur në kushte anonimiteti, pasi nuk janë të autorizuar për të folur për këtë çështje publikisht.

Autoritetet franceze kanë hapur një hetim më 2013 mbi dyshimet se fushata e Sarkozy më 2007 është financuar nga fondet Gaddafi.

Është hera e parë që ai merret në pyetje për këtë hetim. Disa javë më parë ish-bashkëpunëtori i tij, Alexandre Djouhri, ishte arrestuar dhe më pas ishte liruar me kusht.

ARRESTOHET SARKOZY, IA SHEH SHERRIN GADDAFIT



Brice Hortefeux, ish-ministër dhe aleat i ngusht i Sarkozy, po ashtu është marrë në pyetje sot lidhur me këtë rast.

Avokati i Sarkozy nuk ka komentuar lidhur me marrjen në pyetje të klientit të tij.

Sarkozy, i cili ka qenë president nga 2007 deri më 2012, ka mohuar se ka pranuar fonde nga Libia dhe i

ka quajtur këto akuza si "groteske".

Drejtsuesi i fushatës presidenciale të presidentit Nicolas Sarkozy, në vitin 2015, i pat hudhur poshtë të gjithë spekulimet se fushata e elektorale është financuar pjesërisht prej kolonelit Muammar Gaddafi. Në anën tjetër, djali i diktatorit libian, Saif al-Islam Gaddafi, pat deklaruar se Libia do të publikojë të

gjithë detajet bankare ku vërtetohet financimi i fushatës së Nicolas Sarkozy në vitin 2007.

Gazeta britanike "The Independent" qysh në vitin 2013 shkruante për prova të qarta dhe të pakundërshtueshme që tregojnë se ish-presidenti francez, Nicolas Sarkozy ka marrë rreth 50 milion euro nga ish-diktatori i libian, Muammar Gaddafi. "Independent" citonte një burim të afërt me grupin hetimor francez që është ngritur për të zbardhur zërat në fjalë. Sipas këtij burimi, një biznesmen libanez, i identifikuar si Ziad Takieddine emri i të cilit doli gjatë hetimeve si ndërmjetës në dhjetra transaksione monetare mes Francës dhe vendeve të Lindjes së Mesme, ka rrëfyer para hetuesve në Paris se Sarkozy ka përfituar rreth 50 milion euro nga Gaddafi.

Gjithnjë sipas gazetës britanike, biznesmeni mësohet të ketë deklaruar se është në gjendje të dokumentojë me prova të pakundërshtueshme se fushata zgjedhore e Sarkozy në 2006 dhe 2007 është financuar fuqimisht me paratë që mbërrinin nga Tripoli.



NATO transferohet në selinë e re

NATO, më në fund, transferohet në selinë e re, që vlen miliarda euro, pasi probleme teknike shkaktuan vonesa të shumta.

Transferimi i 4 000 punonjësve në selinë e re, që ndodhet pranë asaj aktuale në kryeqytetin belg, do të zgjasë 12 javë.

Gjithashtu, selia e vjetër do të shfrytëzohet gjatë periudhës së transferimit, sipas një zëdhënësi.

Fillimisht, kjo lëvizje ishte planifikuar në fillim të këtij viti, por u shty për shkak të problemeve të sistemit informatik në ndërtesën e re.

Sistemi do të ofrojë sigurinë e të gjitha komunikimeve elektronike të NATO-s, por gjithashtu do të kontrollojë mbikëqyrjen e të gjithë ndërtesës, me më shumë se 1 000 kamera dhe sisteme hyrëse me iris të syrit.

Ndërtimi i selisë së re filloi në vitin 2010 dhe fillimisht u buxhetua në vlerën e 750 milionë eurove (830 milionë dollarë), por, shpenzimet u rritën dhe aktualisht kanë arritur vlerën e 1,17 miliardë eurove.

BE dhe Britania drejt shkëputjet përfundimtare

Mbretëria e Bashkuar dhe blloku European kanë rënë dakord me pjesën më të madhe të marrëveshjes që do të prodhojë një tërheqje të rregullt të Britanisë nga BE-ja, një hap i rëndësishëm përpara ky i njoftuar prej negociatorit të Brukselit për Brexit-in, Michel Barnier.

Të dy palët, sqaroi ai, janë pajtuar me idenë e një periudhe tranzicioni, çka konsiderohet e një rëndësie kyçe. Komentet e tij, Barnier i bëri pas takimit me sekretarin britanik për Brexit-in, David

Davis. Periudha në fjalë do të nisë nga ajo që etiketohet si "Dita e Brexiti-it" - 29 mars 2019, dhe është konceptuar të zbusë rrugën drejt një marrëdhënieje të përhershme partneriteti.

Kompromisi është arritur sipas Barnier edhe në raport me të drejtat e 4.5 milionë qytetarë të BE-së në Britaninë e Madhe dhe 1.2 milionë qytetarëve britanikë në bllokun european pas realizimit të shkëputjes.

Mbetet ndërkohë ende punë për të bërë në lidhje me disa pika

kyçe siç është kufiri i Irlandës së Veriut apo Gjibraltari. Si Londra, ashtu edhe Brukseli shpresojnë që parimet e marrëveshjes mbi periudhën kalimtare të marrin dritën jeshile të liderëve të bllokut gjatë samiti të tij këtë javë. Ky nuk është megjithatë fundi i rrugës, paralajmëron Barnier; "Tranzicioni, - shton ai, - do ta ketë kohëzgjatjen të limituar".

Palët shpresojnë që po të miratohet marrëveshja e tranzicionit, atëherë negociatat do të mund të fokusohen tek natyra e marrëdhë-



nies së përhershme që do të ketë Britania me BE-në, me qëllimin që pakti të marrë dritën jeshile në vjeshtë duke i dhënë kështu kohë vendeve anëtare të bllokut dhe parlamentit britanik ta ratifikojnë përpara brexit-it, marsin e vitit që vjen.

PËR SHKAK TË SHQIPTARËVE MBYLLET NJË BASTORE NË AUSTRI

Pasi që autoritetet e qytetit Vöcklabruck kanë mbyllur një bastore, një numër shqiptarësh kanë zhvilluar një protestë të palejuar para shtëpive private të zyrtarëve të qytetit, shkruan wocnblick.at.



nga shteti të bastores është, sipas kryetarit të Vöcklabruckut, Martin Gschwandter, zhvillimi i lojërave ilegale aty, transmeton albinfo.ch. ndërsa drejtuesit e bastores dhe njerëzit e afërm me ta janë kundër

një vendimi të tillë.

Në një video të publikuar në youtube nga vetë protestuesit, me himnin austriak në sfond, shihen njerëz me transparente duke qëndruar para shtëpive private të per-

sonave të përmendur ndërsa njëri prej tyre, duke thirrur me megafon.

Njëri nga këto aksione të vogla është zhvilluar para shtëpisë së shefit të sektorit për siguri të Vöcklabruckut, siç e tregojnë vetë postuesit e videos.

Demonstruesit në sloganet e tyre flasin për "zyrtarë të korrupuar" të qytetit dhe për "shpërdorim të tatimeve përmes arbitraritetit të zyrtarëve".

Drejtsuesit e bastores kanë bërë edhe ankesë juridike para Gjykatës Administrative të Landit të Austrisë së Epërme, transmeton albinfo.ch. Por kjo gjykatë u ka dhënë

të drejtë autoriteteve të qytetit. Kjo ka bërë që ata të protestojnë edhe jashtë kornizave të lejuara ligjore, duke ushtruar presion mbi punonjësit e shërbimit publik.

Sipas një raportimi televiziv të ORF, familjet me fëmijë të vegjël, banorë të shtëpive para të cilave është protestuar, kanë pasur frikë nga e gjithë kjo. Por policia i ka shuar demonstratat.

Tash ndaj protestuesve do të ngrihen padi për detyrim dhe shpifje. "Ne u kemi bërë thirrje organeve kompetente që të veprojnë në mënyrë konsekuente kundër gjithë kësaj", ka thënë Gschwandner.



Republika e Maqedonisë Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alineja 6, paragrafi 5, paragrafi 8, paragrafi 11 alineja 4, paragrafi 13 dhe paragrafi 14 e Ligjit për punësim në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016 dhe 35/2018), nenit 22, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 08-3205/1 të datës 21.10.2015, Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 08-328/1 të datës 8.2.2016, Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 08-219/1 të datës 29.6.2017 dhe Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 08-1023/1 të datës 06.03.2018, Zyra e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 01/2018

Për punësim të (6) realizuesve – këshilltarë të posaçëm në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

Zyra e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për shkak të plotësimit të vendeve të posaçme të punës në Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për shkak të realizimit të detyrave të punës të këshilltarëve të posaçëm, për angazhim të 6 personave për kohë të caktuar, deri në skadimin e mandatit të funksionarit në të cilin kabinet është i punësuar, publikon shpallje për pozitën në vijim:

1. Këshilltar të posaçëm për transport dhe lidhje – 1 realizues

Kualifikimet e nevojshme:

- Së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, fusha shkencore: arsim;
- Përvojë pune prej së paku 8 vjet në profesion.

2. Këshilltar të posaçëm për zhvillim të shoqërisë multikulturore, interkulturalizmit dhe komunikimeve inter-kulturore – 1 realizues

Kualifikimet e nevojshme:

- Së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar ose shkallë të VIII, fusha shkencore: Etnologjia dhe etnogjeneza;
- Përvojë pune prej së paku 10 vjet në profesion.

3. Këshilltar të posaçëm për investime të huaja – 1 realizues

Kualifikimet e nevojshme:

- Së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, fusha shkencore: shkencat juridike;
- Njohje aktive të gjuhës angleze;
- Përvojë pune prej së paku 5 vjet në profesion.

4. Këshilltar të posaçëm për realizim të Marrëveshjes kornizë – 1 realizues

Kualifikimet e nevojshme:

- Së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, fusha shkencore: shkencat ekonomike, shkencat organizative dhe menaxhim (menaxhment);
- Përvojë pune prej së paku 16 vjet në sferën e kulturës.

5. Këshilltar të posaçëm për transparencë dhe llogaridhënie – 1 realizues

Kualifikimet e nevojshme:

- Niveli i kualifikimeve profesionale V A sipas kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve ose së paku arsim të lartë nga sfera e artit ose arsimit;
- Përvojë pune prej së paku 12 vjet në profesion.

6. Këshilltar të posaçëm për rini dhe sport – 1 realizues

Kualifikimet e nevojshme:

- Së paku 300 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/2 të mbaruar, fusha shkencore: shkencat juridike;
- Pa përvojë pune;
- Njohje aktive të gjuhës angleze – niveli B2 – BULATS;
- Certifikatë për trajnime të mbaruara nga sfera e sportit, komunikimit, vizionit të të rinjve.

Orari ditor i punës është prej ora **07:30/08:30** deri në ora **15:30/16:30**, orari javor i punës është 40 orë – prej ditës së hënë deri ditën e premte. Si kusht i posaçëm për punë në Zyrë është paraparë edhe punë gjatë pushimit javor, punë gjatë kohës së festave të caktuara me ligj, ndërsa për realizim të punëve emergjente dhe që nuk duhet të shtyhen. **Neto pagesa prej 25,000,00 deri në 50,000,00 denarë.**

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet patjetër të dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- Biografi të shkurtër - CV me kontakt telefon dhe adresë të nevojshëm të shkruar;
- Letër motivimi;
- Certifikatës së shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Dëshmi për përvojën e kërkuar të punës;
- Diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit që kërkohet për vendin e punës (original ose kopje të vërtetuar në noter);

Dokumentacioni i nevojshëm të dorëzohet në Arkivin Zyrës së Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ose përmes postës në adresën në vijim:

Zyra e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë,

bul. "Ilinden" nr. 2, 1000 Shkup

(me shenjë "Për shpallje për punësim")

Në anën tjetër të zarfit të shënohet vendi i punës për të cilin aplikohet.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është pesë (5) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor, gjegjësisht më së voni deri më **28.03.2018**

deri në ora **16:30**.

Fletëparaqitjet dhe dokumentacioni i dorëzuara pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.



This Trust Fund is funded by the European Union



EU Local and Regional Competitiveness Project



This Trust Fund is administered by the World Bank

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST Consulting Services – Firms Selection

LOCAL AND REGIONAL COMPETITIVENESS PROJECT (2016-2019)

Grant No.: TF0A1779

Assignment Title: Visibility and Promotional Campaign

Reference No.: MK-LRCP-P154263-C4-21

The Local and Regional Competitiveness Project (LRCP) is a four-year investment operation financed with a grant from the European Union Instrument for Pre-Accession (IPA II) and administered by the World Bank (WB). LRCP intends to apply part of the grant funds for consulting services under this Project.

The consulting services ("the Services") include services for Visibility and Promotional Campaign.

Expected duration for the above referenced consulting services is seventeen months. The Terms of Reference (ToR) are available on the website of the Local and Regional Competitiveness Project (LRCP) at <https://lrp.mk>.

The LRCP now invites eligible consulting firms ('Consultants') to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide their information demonstrating that they have the required qualification and relevant experience to perform the Services. The shortlisting criteria are:

- The Consultant firm should have at least 5 years of proven track record in designing and delivering of public communication campaigns;
- The Consultant firm should provide a proven track record in communication and PR experience in EU funded project and knowledge of EU and World Bank visibility requirements with supporting evidence from the clients and also a list with contact information of clients for successful completion of previous projects of a similar nature;
- The Consultant firm should have proven successful experience in public communication, working inclusively with both public and private sector in complex multi-stakeholder environments;

- The firm should have proven work experience in communication methodology development applicable in complex multi-stakeholder environments;
- The consulting firm should provide creative and innovative portfolio;
- The firm should provide evidence for the ability to conduct population-based and market-based research and to analyze the gathered data;
- The Consultant firm should have proven experience in communicating country tourism issues.

The selected firm should confirm availability of experts in the following areas. Bio data/CVs of individual key experts are not required for the purpose of expressions of interest, just confirmation of availability of required experts:

- Tourism Specialist
- Methodology/Creative Strategy Development Specialist
- PR Specialist
- Event Management Specialist

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's *Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers dated January 2011, Revised July 2014* ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest. Consultants may associate with other firms in the form of a joint venture or a sub-consultancy to enhance their qualifications. The "association" may take the form of a Joint Venture or a sub-consultancy. In case of a Joint Venture (JV), all members of the JV will be evaluated jointly for the purpose of short listing and shall be jointly and severally liable for the assignment and shall sign the contract in case of award is made to that JV group. Interested consultants should clearly indicate the structure of their "association" and the duties of the partners and sub consultants in their application. Unclear expression of interests in terms of "in association with" and/or "in affiliation with" and etc. may not be considered for short listing. Keeping one expression of interest per firm as principle, a consultant firm may decide whether it wishes to participate as a sub consultant or as an individual consultant or as a partner in a joint

venture. Please note that a firm shall submit only one expression of interests in the same selection process either individually as a consultant or as a partner in a joint venture. No firm can be a sub consultant while submitting an expression of interests individually or as a partner of a joint venture in the same selection process. A firm, if acting in the capacity of sub consultant in any consultant or JV, may participate in more than one consultant, but only in the capacity of a sub consultant.

A Consultant will be selected in accordance with the Quality-and Cost-Based Selection method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 8:30 – 16:30 hrs local time.

Expressions of interest on English language must be delivered in a written form to the address below (in person, by mail, or by e-mail) by **Wednesday, April 4th, 2018 before 16:00** hrs local time.

Project Implementation Unit
Local and Regional Competitiveness Project
Attn: Antonija Sisak, PIU Director
(Reference no. MK-LRCP-P154263-C4-21)
Miroslav Krleza Str. 60/1, 1000 Skopje
Tel: +389 (0)2 3253 818
E-mail: antonija.sisak@lrp.org.mk

Njësia për realizim të projektit "Konkurrenca lokale dhe rajonale" publikon ftesë për shprehje të interesimit për realizim të shërbimeve konsulente – firmë konsulente për realizim të fushatës për pamje dhe promovim. Përshkrimi i detyrave të punës (TOR) në gjuhën angleze është publikuar në ueb faqen <https://lrp.mk>. Konsulentët e interesuar duhet të parashtrajnë letër për shprehje të interesimit dhe për informacione të tjera në gjuhën angleze më së voni deri më 4 prill 2018 (e mërkurë), para orës 16:00 sipas kohës lokale, në adresën e theksuar më lartë.



Polio Plus në korniza të projektit Margina Obskura shpall thirrje për grande të vogla për organizatat e personave me handikap

1 Qëllimi- Qëllimi i kësaj thirrje është realizimi i projekteve nga ana e organizatave qytetare të personave me handikap për ngritjen e zërit të personave me handikap në nivel lokal/dhe ose rajonal dhe zbatimi efektiv i Konventës për të drejtat e personave me handikap. Iniciativat e propozuara patjetër që të fokusohen në:

1) Përmirësimin e politikave dhe praktikave të tyre në nivel lokal dhe/ose në nivel rajonal në këto sfera: Zgjedhje inovative për qasje në nivel lokal, Shëndetësi dhe/ose çështje sociale në nivel lokal, Sport dhe rekreacion;

2) Rrjetëzim dhe ndërtim i partneriteteve në mes organizatave të personave me handikap për shkak të krijimit të një zërit në nivel lokal/rajonal;

3) Formimi i modeleve inovative për menaxhim dhe sigurim të shërbimeve të OPH në nivel lokal dhe / ose rajonal;

4) Përmirësimin e kornizës politike dhe praktike për pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve me handikap në procesin e sjelljes së vendimeve.

2. Kriteret për pjesëmarrjen në thirrjen- Thirrja për grande të vogla është e hapur vetëm për organizata qytetare të personave me handikap në Maqedoni. Organizatat e qytetarëve të personave me handikap të cilat i përmbushin këto kriteret kanë të drejtë të aplikojnë:

- Organizata e qytetarëve e regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqata të qytetarëve dhe fondacioneve;

- Të jetë organizatë qytetare e personave me handikap (OPH) Organizatë/shoqatë e personave me handikap është shoqata/organizata në të cilën shumica e anëtarëve janë persona me handikap ose përfaqësues të personave me handikap të cilët nuk mundin të përfaqësohen vetë për veten dhe ku në strukturat menaxhere dhe udhëheqëse janë ekskluzivisht persona me handikap. Të dyja kushte patjetër që të ekzistojnë në mënyrë kumulative;

- OPH e regjistruar së paku 1 vit para shpalljes së kësaj thirrjeje;

- OPH e cila është me seli në Maqedoni dhe realizon aktivitete, në nivel lokal ose nëpër tërë vendin;

3. Mbështetja financiare- Shuma e përgjithshme e cila është e arritshme për këtë Thirrje është 40,000 euro. Grandi i cili do të ndahet me këtë thirrje është në kornizën prej minimum 100.000,00 DMQ deri më 300.000,00 DMQ.

4. Afati përfundimtar. Aplikacionet duhet që të dërgohen nëpërmjet e-postës të polioplus@polioplus.org.mk jo më së voni se data **16.04.2018, në ora 16:00**, me shenjë (lëndë) "Thirrje për Grande të Vogla". Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në formë elektronike në postën elektronike: polioplus@polioplus.org.mk Thirrjen e plotë dhe materialet e nevojshme mundeni që ti gjeni në ueb faqen e Polio Plus – lëvizje kundër handikapit – www.polioplus.org.mk



Projekti është përkrahur nga Bashkimi Evropian në kuadër të IPA Programit për shoqëri qytetare dhe medime 2015.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 14/2018

për punësimin e 1 nëpunësve publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institucion publik komunal për fëmijë - çerden e Fëmijëve Carka Andrevska - Kratovë“ për vendet e punës në vijim:

1. DEZ0102V01002 Këshilltar - Kontabilist, Shërbimi për çështje administrative dhe menaxhim me resurset njerëzore 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveu i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, shkencat ekonomike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrijtje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 24.721,00 denarë

VËREJTJE:

Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.
Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.
Afati i aplikimit zgjatë 20 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.
Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.
Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.
Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.
Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.
Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Në bazë të neneve 125, 125-a dhe 131 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gaz. Zyrtare e RM- së nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 127/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Fakultetin e Shkencave Islame Shkup, nenit 162 të Statutit të Fakultetit të Shkencave Islame - Shkup, si dhe në bazë të vendimit të Këshillit mësimoro-shkencor të FSHI-së të mbajtur më 14.03.2018, shpallet:

KONKURS

Për zgjedhjen dhe ri-zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore dhe në thirrje të bashkëpunëtorëve

I. Shpallet Konkurs për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore- shkencore dhe të bashkëpunëtorëve në Fakultetin e Shkencave Islame Shkup:

1. Një mësimdhënës në fushën e Studimit të Religjioneve dhe lëndën Historia e së Drejtës Islame .

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent- Këshillit mësimor– shkencor të institucionit të arsimit të lartë, nëse e posedon;

- ▶ Kërkesë për zgjedhje dhe rizgjedhje nga kandidatët dhe atë brenda 5 ditëve, prej ditës së shpalljes së konkursi
- ▶ Diplomë për gradën shkencore-doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- ▶ Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- ▶ Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- ▶ Biografi e shkurtër;
- ▶ Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- ▶ Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- ▶ Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- ▶ Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- ▶ Certifikatë e shtetësisë.

*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, të parapara me nenin 125 dhe 125-a të Ligjit për Arsimin e Lartë.

*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Dekanatin e Fakultetit të Shkencave Islame-Shkup, në adresën: f. Kondovë Shkup.

Shkup, 21.03.2018

Fakulteti i Shkencave Islame - Shkup

Në suaza të aksionit tradicional të Qytetit të Shkupit "Ditët e pranverës – Ditët e ekologjisë" dhe për realizim të qëllimit të synuar për promovim dhe popullarizim të kujdesit për ambientin jetësorë, Qyteti i Shkupit shpall:

Konkurs publik

për zgjedhjen e

1. Kompanisë më ekologjike (firmës që me sukses zbaton standardin ISO 14001 dhe jep kontribut për ruajtjen e ambientit jetësorë);
2. Kontributit më të madh në fushën e ambientit jetësorë (persona juridik dhe / ose fizik të cilët me aktivitetet dhe orvatjet e tyre, kanë kontribuar për ruajtjen dhe avancimin e ambientit jetësorë në qytetin e Shkupit, në kuptim të mbrojtjes së medimeve të ambientit jetësorë, zvogëlimin e shfrytëzimit të llojeve jo përtëritëse të energjisë etj.);
3. Oborrit më të rregulluar (oborre të banimit individual, oborre të banimit kolektiv dhe të institucioneve, firmave ose objekteve afariste);
4. Përpilim të punimit më të mirë në temën e ekologjisë (për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme);
5. Vizatim më të bukur në temën e ekologjisë (për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme).

Fletëparaqitjet e qytetarëve të interesuar, organizatat joqeveritare, institucionet publike, ndërmarrjet dhe personat tjerë fizik dhe juridik, të dorëzohen përmes postës në adresën vijuese: Qyteti i Shkupit, Sektori për ambient jetësorë dhe të natyrës, bul. "Ilinden" nr. 82, ose në arkivin e Qytetit, mund të drejtohen edhe në telefonin 02/3297-273 dhe 3297-304.

Për dy kategoritë e para, është paraparë çmimi në shumë prej 45.000 denarë.

Për kategorinë e tretë, për oborrit më të bukur, janë paraparë tre çmime (banim individual, banim kolektiv dhe çmimi për institucionet, firmat ose objektet afariste), në shumë prej 40.000 denarë për secilën nën kategori.

Për kategorinë e katër, janë të parapara dy çmime, një për nxënësit e shkollave fillore dhe një për nxënësit e shkollave të mesme, në shumë prej 10.000 denarë për secilën nën kategori.

Për kategorinë e pestë, janë të parapara dy çmime, një për nxënësit e shkollave fillore dhe një për nxënësit e shkollave të mesme, me nga 10.000 denarë për secilën nën kategori.

Shqyrtimi i fletëparaqitjeve të dërguara dhe përzgjedhja e kandidatëve do të realizohet nga komisioni përkatës, të cilin Qyteti i Shkupit do ta formojë nga radhët e përfaqësuesve të punonjësve nga sektorët e Qytetit të Shkupit dhe nga organizatat joqeveritare.

Paraqitja fillon menjëherë dhe zgjat deri më 15 maj të vitit 2018. Shpallja e fituesve për të gjitha kategoritë do të mbahet në sauzat e kremtimit të Ditës botërore për mbrojtjen e ambientit jetësor, nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit.

Koha, e mërkurë 21 mars, 2018

MAQEDONIA E KOMPLETUAR VAZHDON PËRGATITJET NË ANTALIA

DUAM FITORE NË TË DYJA PËRBALLJET



"Besojmë se fillimisht mund të përgatitemi mirë dhe pastaj të ofrojmë paraqitje të mira në dy ndeshjet e ardhshme miqësore. Atmosfera në përfaqësuese është shumë e mirë dhe kjo premtion një paraqitje të re kualitative nga ana jonë. Të gjithë e dimë rezultatet nga këto dy ndeshje janë të rëndësishme dhe për këtë arsye ne dëshirojmë fitore në të dyja përballjet", pohon mbrojtësi Musliu

Shkup, 20 mars - Përfaqësueses së Maqedonisë e cila po përgatitet në qendrën Belek të Antalias, i janë bashkangjitur edhe tre futbollist, Stefan Ristovski (Sporting Lisbon), Ezgjan Alioski (Lids) dhe Stole Dimitrievski (Taragona). Ndërkaq, seleksionuesi Igor Angelovski me formacion të

kompletuar i ka filluar përgatitjet për dy ndeshjet e parapara miqësore. Ndryshe, mbrojtësi Ristovski pasi iu bashka grupit, përfaqësueses së FFM-së tha se në ndeshjet kontrolluese fitojnë pasqyrë për atë se çka i pret pas disa muajve dhe fillimin e ndeshjeve të rëndësishme të Ligës së Kombeve. "E kemi të qartë se nga ne pritet që të jemi në formën e vërtetë para ndeshjeve të Ligës së Kombeve, por në këto ndeshje kontrolluese fitojmë pasqyrë për atë se çka na pret në të ardhmen. Mendoj se është e rëndësishme ta forcojmë karakterin e ekipit në këto përballje dhe të vazhdojmë të punojmë. Atmosfera në mesin tonë është e shkëlqyer, gjithmonë na vjen mirë kur kthehemi në fanellën e përfaqësueses dhe këto dhjetë ditë do të shfrytëzojmë për komunikim dhe afrim më të madh. Gjithsesi, shpresoj se do të jemi në nivel edhe në

ndeshjet kundër Finlandës fillimisht dhe më pas Azerbajxhanit", deklaroi Ristovski. Në anën tjetër, Marjan Radeski dhe Visar Musliu janë futbollistët e vetëm nga radhët e KF Shkëndija, pasi paraprakisht për shkak të lëndimit Ferhan Hasani nuk mundet ti përgjigjet ftesës së seleksionuesit Angelovski.

"Besojmë se fillimisht mund të përgatitemi mirë dhe pastaj të ofrojmë paraqitje të mira në dy ndeshjet e ardhshme miqësore. Atmosfera në përfaqësuese është shumë e mirë dhe kjo premtion një paraqitje të re kualitative nga ana jonë. Të gjithë e dimë rezultatet nga këto dy ndeshje janë të rëndësishme dhe për këtë arsye ne dëshirojmë fitore në të dyja përballjet", deklaroi Musliu. Ndërkohë, ndeshjen kundër Finlandës, Maqedonia do ta zhvillojë më 23 mars në ora 17.00.

Nuk u mendova dy herë, i kam pasur ëndërr ngjyrat kuqezi



Bujar Lika është një prej futbollistëve të rinj të grumbulluar për herë të parë në Kombëtaren e Shqipërisë. 25-vjeçari, i lindur në Ferizaj, shpjegoi në konferencën për shtyp se nuk u mendua gjatë kur Panuçi e ftoi të ishte ngjyrat kuqezi. "Kam pasur shumë dëmtime, por vitin e fundit kam mundur ta tregoj veten, pastaj erdhi kontakti me Panuçin. Kam zgjedhur Shqipërinë, nuk kam pasur kontakt nga Kosova. Nuk u mendova dy herë për të vendosur. Gjithnjë e kam pasur ëndërr për të luajtur me ngjyrat kuqezi, kaq. Pres të aktivizohem në miqësore. Është kënaqësi edhe për familjen time", u shpreh

Lika. "Lojtarët më kanë pritur shumë mirë, sidomos ata të Zvicrës. Atmosfera është shumë e mirë. Kjo është një mundësi e madhe për mua të tregoj veten. Sa i përket bisedës që kisha me Panuçin, ai asgjë nuk më ka premtuar. Jam këtu për të treguar veten. Konkurrenca është e madhe duhet të tregoj veten", deklaroi Lika, futbollisti aktual i skuadrës zvicerane Grass'hopper. Cekim, Lika është 25 vjeç, me origjinë nga Kosova, por me pasaportë zvicerane. Është rritur te Lucerna, ndaj trajneri aktual i Grass'hoppersit, Murat Jakin, e njej mirë, duke qenë se ka punuar te Lucerna në sezonin 2011/2012. Prej vitit 2013 Lika ka luajtur te Voleni në divizionin e dytë zviceran dhe sezonin e shkuar u bë titullar fiks, ndërsa këtë sezon e nisi te Shafhauzeni, sërish titullar. Paraqitjet e tij nuk kaluan pa rënë në sy dhe pikërisht Jakin e kërkoi në janar, me Grass'hoppers që firmosi një kontratë 1,5-vjeçare me anësin e djathtë, i cili ka luajtur 5 ndeshje këtë vit në Superligën zvicerane, duke dhënë edhe një asist në humbjen 2-1 ndaj Lucernës.

Bashkohen forcat për një spektakël të madh në Zvicër

Shkup, 20 mars - Shteti i Zvicrës shumë shpejt do të pasurohet edhe me një evitimet të madh të sporteve luftarake, por kësaj radhe me një koncept ndryshe nga të tjerët dhe me plot befasia. Bashkë organizator janë tre persona, secili profesionist në punën e tyre dhe me një bagazh të madh në sportet luftarake, por edhe në organizime të tilla. Të njëjtit janë dëshmuar me organizimet që kanë pasur në të kaluarën kurse tani kanë mbledh forcat për një spektakël që do organizohet ose në Bazel ose në Cyrih më 22 shtator 2018. Bëhet fjalë për Valdet Bajramin i cili do të jetë edhe president, Urim Saiti dhe Avdyli Salihu. Evenimenti do të quhet "The Money Challenge" ku organizatorët përveç përballjeve prestigj, kanë paraparë edhe ndeshje për titull Evropë, ku në njërin do ndeshet kërcovari, Urim Saiti. Poashtu në program do ketë edhe një turnir nga tetë luftëtar në K1, ku do luftojnë për çmimin e madh prej 10.000 franka. Nga tani organizatorët kanë filluar edhe kontaktet e para me kik-boksier dhe boksier të njohur shqiptar ku disa prej tyre madje janë pajtuar që të mar-



rin pjesë, por momentalisht nuk dëshirojnë që emrat e tyre të bëhen publike deri në momentin kur do gjinden dhe kundërshtarët e tyre. Me një fjalë shumë mirë është pritur ky eveniment tek sportistët dhe pritet një Mega spektakël i madh, ku do jetë edhe tradicional. Presidenti i "TMC", Valdet Bajrami u shpreh shumë i gëzuar me këtë projekt të ri që do e realizoj me bashkëpunëtorët e tij, Urim Saiti dhe Avdyli Salihu dhe premtoj se puna e tyre do të shihet qysh në eventin e parë. "Kemi biseduar shumë gjatë me Urimin dhe Avdylin për konceptin, madje kemi bi-

seduar edhe për gjërat ma të thjeshta vetëm e vetëm që dalim të suksesshëm. Të gjithë kemi pas përvojë me organizime dhe të njëjtat i kemi paraqit në flet, ndërkohë që kemi futur në program disa gjëra që do jenë risi në evente dhe mendoj se të njëjtat do të pranohen shumë mirë edhe nga shikuesit. Nga tani e shoh se kemi mbështetje të madhe edhe nga sportistët, kështu që apeloj secili që mendon se mund të ngjitet në ringun tonë mund të na kontaktoj dhe në fund do të kënaqemi të gjithë me atë spektakël që do e organizojmë", deklaroi Bajrami.

KOMUNA E GOSTIVARIT
ОПШТИНА ГОСТИВАР
GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-223/5
19.03.2018 vit
Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

L A J M Ē R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridikë se për Projektin Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) **për formimin e parcelave ndërtimore në PK nr. 2983 për KK Banjicë me dedikim A1**-Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizim e:

PREZANTIMIT PUBLIK DHE ANKETËS PUBLIKE

Për Projektin Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) **për formimin e parcelave ndërtimore në PK nr. 2983 për KK Banjicë me dedikim A1** - Komuna e Gostivarit, që kufizohet ndërmjet rrugëve:

- Nga ana veriore me rrugën ekzistuese
- Nga ana lindore parcelën kadastrale PK nr. 2968/2
- Nga ana jugore me rrugën ekzistuese
- Në anën perëndimore me parcelat kadastrale PK nr. 2982/1 ; PK nr. 2982/2

Prezantimi publik do të mbahet në mjediset e Komunës së Gostivarit, respektivisht në sallën e Këshillit të Komunës së Gostivarit më datë **26.03.2018 (e hënë) në ora 13:00.**

Projekti Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) **për formimin e parcelave ndërtimore në PKnr.2983 për KK Banjicë me dedikim A1**-Komuna e Gostivarit do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit, do të zgjasë 5 ditë pune prej **26.03.2018 deri 30.03.2018**, çdo ditë pune prej orës **08:00-16:00.**

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit, si dhe në sistemin e-urbanizëm, kurse në afatin e paraparë personat e interesuar juridikë dhe fizikë mund të parashtrajnë vërejtjet me shkrim në fletët anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e-urbanizëm.

Kryetari i Komunës
Arben Taravari

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 120/2011, 10/2012, 11/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), Drejtori i IPÇF "Detska Radost" – Komuna e Gazi Babës - Shkup publikon

SHPALLJE Për punësim për kohë të pacaktuar të

1. 2 (dy) përkëdhelës me shkollim të mesëm katërvjeçar, dhe licencë të vlefshme për përkëdhelëse, me përvojë pune.
2. 1 (një) edukator, profesor i diplomuar për mësim parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor me 240 kredi sipas ECTS ose të ketë të mbaruar arsimin përkatës shkallën VII/1 ose arsim të lartë përkatës për edukator dhe me licencë valide për edukator, me përvojë pune.
3. 1 (një) gjellëbërës, PMP shkalla IV profesionale – shkolla e mesme e hotelierisë me dhe pa përvojë pune
4. 1 (një) mirëmbajtës të higjienës – arsim fillor ose të mesëm – me ose pa përvojë pune

Së bashku me fletëparaqitjen kandidati duhet të parashtrijë:

- Dëshmi për arsim të mbaruar përkatës (dëftesë, diplomë, certifikatë);
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikatë të mjekut;
- Vërtetim për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi të mos i jetë shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm me të cilën është gjykuar me vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes apo keqpërdorim i personit të mitur, për vepër penale të akteve kundër lirisë së gjinisë, pa marr parasysh sanksionit të shqiptuar në të cilën në pajtim me ligjin është vërtetuar sjellje diskriminuese

Afati për parashtrimin e dokumenteve është 5 ditë pune, duke konsideruar nga dita e ardhshme e publikimit të shpalljes.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditë pune pas kalimit të afatit për paraqitje.

Orari i punës së:

vendi i punës përkëdhelës është 40 orë në javë (e hënë – e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është i nivelizuar në periudhë prej ora 06,00-18,00.

vendi i punës edukator është 40 orë në javë (e hënë – e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është prej ora 07,00 - 15,00.

vendi i punës gjellëbërës është 40 orë në javë (e hënë – e premte), ndërsa orari ditor i punës është prej 06,00 - 14,00.

vendi i punës mirëmbajtës të higjienës është 40 orë në javë (e hënë – e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është i nivelizuar në periudhë prej ora 06,00-18,00.

-Neto pagesa fillestare për vendin e punës:

Përkëdhelës është 14.722,00 denarë, edukator është 19.573,00 denarë, gjellëbërës me PMP shkalla IV është 13.719,00 denarë, mirëmbajtës të higjienës është 12.005,00 denarë

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i pa rregulluar nuk do të shqyrtohet.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen deri në:

IPÇF "Detska Radost" – Komuna e Gazi Babës - Shkup

rr. "Bapçor" nr. 2

tel: 02 3173-663

1000 Shkup

IPÇF "DETSKA RADOST" – Komuna e Gazi Babës - Shkup

DREJTOR
LILJANA KRSTEVSKA

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/2015), Drejtori i SHFK "Todor Janev" Çashka publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të personelit teknik për kohë të pacaktuar të punës për vendin e punës në vijim

Mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës 40 (dyzet) orë pune në javë, pagesa bazë 12.000,00 denarë. 2 realizues

Orari ditor i punës është 8 (tetë) ditë edhe atë prej ora 08:00 deri në ora 16:00. Orari javor i punës me orar të plotë të punës është 40 orë të shpërndara në 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune edhe atë: -të kenë arsim përkatës të nevojshëm për vendin e punës (arsim fillor/të mesëm) -të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë (përkatësia shqiptar)

Së bashku me fletëparaqitje për punësim duhet të parashtrihen dokumentet në vijim edhe atë:

- Dëftesa për arsim të mbaruar përkatës
- Certifikatë të shtetësisë

Dokumentet parashtrihen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen në adresën SHFK "Todor Janev" – Çashka, rr. 8-mi Septemvri nr. 1 – Çashka.

Drejtor
/Violeta Spirkovski/

Në bazë të nenit 17 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënësit dhe aktivitetet tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore numër 07-9992/2 të datës 05.06.2014 të sjellë nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Shkolla fillore komunale Aleksandar Makedonski – Aerodrom – Shkup, publikon

SHPALLJE

Për grumbullimin e ofertave për organizim të aktivitetet për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira për vitin shkollor 2017/2018

1. **PËRDORUES** – SHFK Aleksandar Makedonski me seli në rr. 1612 nr. 4 –Komuna e Aerodromit, Shkup tel 02/6152-513
2. **OFERTUES** – Të drejtë për parashtrim të kërkesës për organizim të ekskursioneve dhe aktivitetet tjera të lira për nxënësit ka çdo subjekt i interesuar juridik që është i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën e marrëveshjes.
3. **LËNDA E MARRËVESHJES ËSHTË E NDASHME DHE KA TË BËJË ME:**

1. Piknik pranveror për nxënësit e klasës së I deri IX

2. Mësim në natyrë për nxënësit e klasës së V

3. Ekskursion njëditor për nxënësit e klasës së III

4. Ekskursion dyditor për nxënësit e klasës së VI

5. Ekskursion treditor për nxënësit e klasës së IX

Ofertat duhet t'i përmbushin kushtet e caktuara në dokumentacionin tenderues që mund të merret në shkollë, çdo ditë pune prej ora 10 deri në ora 12.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit të saj.

Ofertat të parashtrihen më së voni deri më 27.03.2018, deri në ora 10:00, në arkivin e SHFK "Aleksandar Makedonski" – Shkup, rr. 1612 nr. 4 1000 Shkup, ndërsa hapja e të njëjtave do të jetë në ora 13.

SHFK "Aleksandar Makedonski" – Shkup

Komisioni për grumbullimin e ofertave për organizim të ekskursioneve dhe aktivitetet tjera të lira

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1, nenit 184 e Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/09, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/15, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016, 127/2016), nenit 34 paragrafi 2 dhe nenit 35 e Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/13), Vendimit nr. 02-272/1 nga 20.3.2018, Dekani i Fakultetit të edukatës fizike, sportit dhe shëndetit në Shkup, publikon

KONKURS

Për zgjedhje të

- Një mësimdhënësi në titujt mësimor, për realizimin e mësimin për lëndën Sport dhe shëndet me studentët e fakulteteve jo amë në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (zgjedhja është për periudhë prej 4 (katër) vjet.

Kushtet: Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror dhe aktet tjera të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrijnë: biografi të shkurtë, dëshmi për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës, certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror, dhe akteve tjera të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është për kohë të caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen në adresën: Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet në Shkup, rr. Dimçe Mirçev nr. 3, 1000 Shkup, Fahu P. 681

Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet – Shkup

Në bazë të nenit 131 paragrafi (1) dhe (2), të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/16), neneve 34 dhe 35 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/2013), Fakulteti i medicinës në Shkup, në kuadër të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS

Për zgjedhje në titujt shkencor dhe titullar

I. TRANSFUZIOLOGJIA

- 1 person në të gjitha titujt shkencor në sferën shkencore:
- Transfuziologji

II. MEDICINA INTERNE

- 1 person në thirrjen titullare, në sferat mësimore-shkencore:
- Medicina interne
- Toksikologjia

Kushtet: Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Ligjin për veprimtari shkencore – hulumtuese, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe me aktet tjera të Fakultetit dhe Universitetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitja me dokumentacion të kompletuar dorëzohet në arkivin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Fakulteti i medicinës – Shkup në rr. 50-ta Divizija nr. 6, Shkup.

Fakulteti i medicinës – Shkup,
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup



ENDE HERËT QË TË BËHEM TRAJNER I SOSIEDADIT

Jam ende në kurset e mia dhe ende stërvit, por unë sapo kam dalë në pension kohëve të fundit nga futbollit kështu që koha do të tregojë se çfarë ka të ardhme dhe çfarë është puna ime e ardhshme

Ish-mesfushori i Real Sociedadit, Çabi Alonso e ka përjashtuar veten nga mundësia për të qenë zëvendësimi i përhershëm për trajnerin e larguar Eusebio Sakristan. Klubi bask e ka shkarkuar trajnerin Sakristan dhe në vend të tij e ka emëruar Imanol Alguacil deri në fund të sezonit, por Alonso nuk beson se ai do të jetë gati deri në verë për të marr drejtimin e Sociedadit. "Unë jam ende shumë i ri për një rol të tillë stërvitor dhe nuk jam kuali-

fikuar ende plotësisht për këtë punë", ka thënë fillimisht Alonso për "Marca". "Jam ende në kurset e mia dhe ende stërvit, por unë sapo kam dalë në pension kohëve të fundit nga futbollit kështu që koha do të tregojë se çfarë ka të ardhme dhe çfarë është puna ime e ardhshme. Duhet ta vlerësojmë punën që Eusebio bëri gjatë dy viteve të tij në punë, dhe futbollit shpesh mund të jetë mosmirënjohës dhe pa falje në këtë drejtim. Pozita e traj-

nerit është gjithmonë e vështirë dhe ai ka bërë një punë të shkëlqyeshme, dëshiroj ta falënderoj atë për punën e tij në klubin tim dhe t'i uroj atij të mirën për të ardhmen. Vendimi për të emëruar Imanol është i arsyeshëm, ai ka një shans për të bërë përshtypje të mira dhe ai e njeh mirë klubin", deklaroi Alonso. Në fund Alonso ka folur edhe për lajmin për shmangien e taksave, por ka thënë se është gjithçka në rregull.



Sandro lëndohet në stërvitje me Brazilin

Lajmet e këqija nuk vijnë kurrë vetëm. Kështu, në shtëpinë e Juventusit, pas dëmtimi të Kielinit, po presin me shqetësim të kuptojnë seriozitetin e dëmtimit të Aleks Sandro, mbrojtësi i majtë brazilian, të cilin Allegri e ka aktivizuar edhe si sulmues krahu ose, siç ka ndodhur në derbin kundër Torinos, edhe si qendërsulmues pas ndalesës së Higuain. Nuk ka akoma lajme zyrtare në lidhje me seriozitetin e dëmtimit, por fakti se ai ka braktisur stërvitjen e fundit me Brazilianin është një sinjal alarmues: një prerje në kofshën e djathtë e ka detyruar të ndalet. Nëse ka qenë thjesht një masë parandaluese apo diçka më e rëndë do të mësohet në orët në vazhdim, por nuk është një lajm i mirë për një ekip që duhet të përballet me problemet fizike të Manxhukit, Kuadrado, Bernardeski. Me kthimin e ndeshjes pas takimeve të kombëtareve, Juventus do të luajë një sfidë të rëndësishme 31 marsin e ardhshëm kundër Milanit, që në këtë moment është një nga kundërshtarët më të vështirë. Një takim ky që do të zhvillohet pak ditë para ndeshjes së parë çerekfinale kundër Real Madrid në "Champions League". Këto probleme fizike mund të jenë "fatale" për një ekip që është në garë për të fituar gjithçka në këtë sezon.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15), Konvikti shtetëror për studentë "Koço Racin" – Manastir, publikon

SHALLJE

Për punësim të punëtorëve në vijim

- Dy enëlarëse për kohë të pacaktuar, orari i punës me dy ndërrime: prej 40 orë pune në javë – ndërrimi i parë dhe ndërrimi i dytë, me arsim fillor të mbaruar me neto pagesë prej 15 642.77 denarë.
- Një mirëmbajtës të higjienës për kohë të pacaktuar, me orar të punës prej 40 ditë pune në javë, me arsim fillor të mbaruar me neto pagesë prej 14 983.38 denarë.
- Një mjeshtër të përgjithshëm për kohë të pacaktuar me orar të punës prej 40 orë pune në javë, me arsim të mesëm të mbaruar të elektroteknikës dhe dy vjet përvojë pune, me neto pagesë prej 20 074.25 denarë.

Dokumentet e nevojshme:

- Lutje
- Certifikatë të lindjes (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Dokumentet e nevojshme në lidhje me shpalljen të parashtrihen në arkivin e Konviktit ose në adresën në vijim: Konvikti shtetëror për studentë "Koço Racin" – Manastir, rr. Studentska nr. 2, në ndërtesën administrative, Manastir.

Shpallja zgjatë (5) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Konvikti shtetëror për studentë
"Koço Racin" – Manastir
Drejtor:
Sonja Karapec

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 74/2015), SHFK "Kiril i Metodi" Sveti Nikole publikon

SHALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të pacaktuar të punës

1. Një punëtor të ngrohjes – punëtor të kazanëve për ngrohje, pagesa fillestare 14.747
2. Tre mirëmbajtës të higjienës, pagesa fillestare 12.000

Kandidatët duhet të parashtrorjnë lutje, diplomë për arsim të mbaruar përkatës, certifikatë të shtetësisë, nën pikën 1 të kenë certifikatë për preventivë dhe menaxhim në gjendje krize dhe certifikatë për PSP. Orari i punës: ndërrimi i parë prej ora 06 deri në ora 14, ndërrimi i dytë prej ora 12 deri në ora 20.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 7 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

SHFK "Kiril i Metodi"
rr. "Angel Trajcev nr. 40, Sveti Nikole

LAJMËRIM

Afati për paraqitje të kandidatëve të interesuar për regjistrim në aftësim dhe përsosmëri profesionale për gjininë aviaçion të Akademisë ushtarake "Gjeneral Mihaillo Apostollski" – Shkup, të personave me cikël të parë të mbaruar të studimeve për nevojat e Ministrisë së mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë, në lidhje me konkursin e publikuar më datë 07.02.2018 në gazetën ditore Veçer dhe Koha vazhdon deri më **18.05.2018**.

Me respekt,
Akademia ushtarake

Shitet lokal afarist në Q.T. Mavrovka me 326 m2.
Çmimi sipas marrëveshjes. **Kontakt telefoni 078/386 386**

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro.
Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221



REPUBLIKA E MAQEDONISË
Universiteti "Shën Kiril dhe Metodi" – Shkup
Fakulteti për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike



LAJMËRIM

Universiteti "Shën Kiril dhe Metodi" – Shkup, Fakulteti për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike publikon lajmërim se më datë 29.3.2018 në ora 12 në amfiteatrin e Fakultetit, do të mbahet mbrojtja publike e disertacionit të doktoratës me temën "Korniza për zhvillim të aplikacioneve shkencore" nga ana e kandidatit Bojana Koteska.

Fakulteti për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike – Shkup

ANULIM I SHALLJES PËR THEMELIM TË MARRËDHËNIES SË PUNËS PËR KOHË TË PACAKTUAR TË PUNËS

Anulohet shpallja për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar të punës për punëtor për mirëmbajtje të shtëpisë së Konviktit shtetëror të studentëve "N. H. Orde Çopella" Prilep, të publikuar në gazetën ditore "Koha" më datë 19.03.2018.

Konviktit shtetëror i studentëve "N. H. Orde Çopella" Prilep

Derbi Milan-Inter, i vlefshëm për javën e 27-të të Serie A, shtyrë për shkak të ndarjes së papritur nga jeta të Davide Astori do të luhet më 4 prill. Megjithatë kjo datë ka bërë që administratori i Milanit, Fassone dhe ai i Interit, Antonello, të futen në një "luftë"

Derbi i Madonninës, mes Milanit dhe Interit do të luhet zyrtarisht më 4 prill, në orën 18:30, por pikërisht kjo datë ka bërë që sfida të fillojë para kohe. Ishte Administratori i Deleguar i Milanit, Marko Fassone, që para ndeshjes së djeshme ndaj Kievos, të akuzonte zikaltrit për mungesë bashkëpunimi. "Ne donim që derbi të luhej më 25 Prill ose më 1 maj, pra në ditë festash, që të krijojmë kushtet për një pjesëmarrje masive në shkallët e stadiumit. Gjithsesi, ka një rregull që i jep të drejtë Interit të thotë jo dhe zikaltrit kë-

DERBI I MILANOS FILLON ME PËRPLASJEN E DREJTUESVE



shtu bënë. Jam shumë i keqardhur", tha Fassone. I menjëhershëm ishte edhe reagi- mi i zikaltrëve, nëpërmjet CEO-s

së vet, Antonello. "Nuk e kuptoj pse duhet të bëhet problem me- diatik një çështje për të cilën ven- dosi rregullorja. Federata zbatoi

rregulloren për të gjitha ndeshjet e shtyra pas vdekjes së Astorit dhe pjesëmarrja e tifozërisë nuk na u duk shkak për të shkelur rregullo-

ren. Tifozët do ta mbushin 'San Siro' edhe në këtë derbi", tha Antonello. Mediat italiane raportojnë se propozimi i Milanit për të shtyrë derbin më 25 prill ose 1 maj, ishte disi djallëzor, pasi do të luhej 4 ditë para ose 4 ditë pasi zikaltrit të përballëshin me Juventusin në 'San Siro', çka do të ishte në disfavor të tyre.

Cekim, Serie A anuloi të gjitha ndeshjet e programuara duke mbajtur zi për kapitenin e Fiorentinës që u gjend pa jetë në hotelin ku ishte grumbulluar skuadra. Mes ndeshjeve të anuluar u gjend edhe derbi mes Milanit dhe Interit.

Për ta përforcuar këtë, është fakti që Milani do të luajë transfertën ndaj Juventusit vetëm 4 ditë para derbit që do të luhet tashmë më 4 Prill.

Shokët ankohen sepse ua fus topin mes këmbëve!

Talenti i Borussia Dortmundit, Jadon Sanço, ka pranuar se atij i është ndalur të fusë topin mes këmbëve të futbollistëve të tjerë gjatë seanceve stërvitore. Sanço ka lënë një përshtypje të shkëlqyer te skuadra gjermane, kur u ble gjatë verës nga Manchester Siti për 10 milionë sterlina. Aktualisht i dëmtuar në ligatet e kavaljes, Sanço ka marrë vlerësimet maksimale nga trajneri Peter Stoger dhe shihet si e ardhmja e klubit gjerman. Në një intervistë për "JD Football", Sancho zbuloi: "Ia kam futur topin mes këmbëve kapitenëve Marsel Shmelzer) dhe Vinsent Kompani nga Manchester Siti dhe ata më kanë thënë të mos e bëj më diçka të tillë. Shokët e mi janë ankuar për këto veprime gjatë stërvitjes dhe tani te Dortmundi ka manë ndalur kategorikisht diçka të tillë. E kuptoj që tani gjërat janë më serioze, por ajo është një mënyrë e të shprehurit", deklaroi Sanço. Ai është shpallur kampion bote me Anglinë U-17 dhe deri tani ka luajtur gjashtë ndeshje në Bundesligë.



Lioni rrezikon përjashtimin nga kupat evropiane

Skuadra franceze Lion po përballet me përjashtim nga garat evropiane, pasi është akuzuar nga UEFA për probleme të shkaktuara nga tifozët para ndeshjes së kthimit të Ligës së Evropës kundër CSKA Moskës, që e humbi të enjten. Lioni ka aktualisht një dënim me kusht prej dy vjetëve që daton nga prilli i vitit 2017, për probleme të shkaktuara nga tifozët gjatë ndeshjes çerekfinale të Ligës së Evropës. Rregullat e UEFA-s thonë. "Nëse ndodh një shkelje tjetër gjatë periudhës me kusht, hyjnë në fuqi masat e parapara disiplinore. Kësaj mund t'i shtohen edhe masa të tjera disiplinore për shkak të shkeljeve të



reja", shkruan "BBC". Lioni është akuzuar për sjellje raciste, për trazira të tifozëve, për hedhje të gjësendeve, ndezje të mjeteve piroteknike dhe bllokim të shkallëve gjatë

ndeshjes me CSKA Moskën. Federata Evropiane e Futbollit (UEFA) do të merret me rastin më 31 maj. Lioni aktualisht zë vendin e katërt në Ligue 1 të Francës, me dy pikë

prapa Marsejtit, ndërsa tri skuadrat e para nga elita franceze kualifikohen në Ligën e Kampionëve, derisa e katërta shkon në Ligën e Evropës...

Nejmar ndryshon modelin e flokëve

Në pritje për t'u kthyer në fushë, pas operacionit në këmbën e djathtë, Neymar Jr ka vendosur të ndryshojë modelin e flokëve. Sulmuesi brazilian i Paris Sen Zhermen i cili po e kalon periudhën e rikuperimit nga dëmtimi në pallatin e tij të ëndrrave në Mangaritiba është bindur nga disa miq të tij për të ndryshuar luk dhe për të bërë modelin e flokëve me rasta. Pasi e ka ndryshuar pamje Neymar ka postuar një foto në profilin e tij në "Instagram" në versionin "rastaman".





DASHI 21. mars - 20. prill

Mërkuri dhe Venusi janë në formë të mirë dhe me ardhjen e pranverës ato bëhen edhe më të forta dhe më të sigurt. Entuziazmi juaj do t'ju lejojë të jeni në harmoni me partnerin/en tuaj. Ditë me pesë yje edhe për beqarët, dashuria, puna dhe fati do të jenë në krye! Përfitoni nga kjo ditë për të filluar të punoni në një punë që mund t'ju sjellë përfitime.



DEMI 21. prill - 21. maj

Zakonisht nuk doni t'i mbyllni marrëdhëniet definitivisht, por tani është koha për ta kthyer faqen. Ju duhet më shumë qetësi të shikoni për të ardhmen. Në këtë ditë, zemrat e vetmuara mund të nisin një marrëdhënie vetëm nëse do jenë totalisht të bindur. Diskutimet dhe polemikat kanë vënë një tendosje në marrëdhëniet tuaja në punë, jini diplomatik dhe gjithçka do të vendoset poshtë.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Hëna sot do t'ju ndihmojë të mbani marrëdhënie të mira dhe distancën e duhur midis rregullave dhe ëndrrave. Mbrëmja do të kalojë e bukur në intimitet me partnerin/en, mundësi edhe për të planifikuar të ardhmen e një çifti. Beqarët do të kenë kredencialet e duhura për të kryer një histori dashurie të lindur kohët e fundit.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Ditë e madhe për të lindurit e Gaforres! Aleanca e Hënës me Mërkurin dhe Jupiterin ju bëjnë optimistë. Impulse të mëdha pasioni për çiftet. Është gjithashtu një moment interesant edhe për ata që janë vetëm që duhet të marrin vendime në lidhje me çështjet private dhe familjare. Është koha për projekte të formateve të mëdha, në këtë fazë ju jeni në gjendje të krijoni plane.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Nëse keni marrëdhënie të mbyllura, ose keni marrë vendime vendimtare, tani mund të rishikoni hapat më tej. Është një periudhë interesante për të zgjidhur problemet e pazgjidhura, veçanërisht ato sentimentale. Beqarët do të duhet të merren me një ish që kthehet, kini kujdes nga thashethemet. Mund të ketë vështirësi nga pikëpamja ekonomike.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Shmangni polemikat dhe kritikën, partneri/ja nuk mund të durojë komentet tuaja. Jini edhe më pak të ngurtë me veten dhe bëni një pushim për të reflektuar. Hëna nuk është më në opozitë dhe beqarët mund t'i afrohen një personi. Ju po përmirësoni vazhdimisht pozicionin tuaj, madje edhe rezultate më të mira ju presin në punë.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Hëna miqësore do t'ju mësojë vlerën e intuitave, të gjërave që bëhen me zemër. Pasioni do të jetë në krye për një person që ju doni, nga ana e të cilit/ës nuk do të mungojë entuziazmi. Yjet do përmirësojnë të gjitha marrëdhëniet emocionale për beqarët dhe kjo do bëjë të ndihen më pak të vetmuar. Në vendimet tuaja profesionale mos lejoni të ndikoheni nga pritjet e të tjerëve.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Sot mund të ballafaqoheni me guxim me sqarime në një mënyrë më aktive sesa në të kaluarën. Momente tensioni në çift, por që do të kalojnë shpejt. Ditë interesante dhe pozitive për ata që janë vetëm, do të jeni përpara nëse veproni para se të jetë tepër vonë. Mundësi të reja për të rritur perspektivat në punë, mos harroni të tregoni se jeni me vlerë.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Dinamik dhe aktivë, sot ju do të tregoni entuziazmin tuaj në të gjitha fushat. Ju e dini se si ta magjepsni partnerin/en dhe të kënaqni çdo nevojë të tij/saj sot është prioriteti juaj! Periudhë me fat në dashuri edhe për beqarët, shpirti binjak është pranë jush, mjafton ta gjeni atë. Ju mund të arrini objektiva të mëtejshme, por më parë duhet të zgjidhni një çështje që ju pengon.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Nuk është koha e duhur për të ekspozuar shumë, madje edhe në dashuri mund të keni distancuar veten nga dikush që ju ka zhgënjyer. Për çiftet e konsoliduara, marrëveshja është shumë e mirë. Për beqarët që duan të bien në dashuri ka takime interesante, nuk duhet t'i humbisni! Në sferën profesionale mund të ketë disa tensione, më mirë të jeni të kujdesshëm me fjalë.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Hëna dhe Mërkuri do të jenë gati për të mbrojtur sektorin sentimental të Ujorëve. Sot do të ketë shumë momente të ëmbla dhe romantike. Beqarët do të kenë një dëshirë të madhe për të ndryshuar disa aspekte të jetës së tyre, për të qenë më të qetë. Disa dyshime profesionale ju mundojnë, por ende është herët për të marrë vendime të mëtejshme.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Shqetësimi për të dashurin/en ju ka mbajtur në tension, por tani jeni të lirë nga të gjitha kufizimet dhe mund të vendosni pa vonesë. Megjithatë, jepini shpjegime personit që ka qenë afër jush deri më tani. E marta pritet të jetë një ditë e ngjeshur për ata që janë vetëm, do ketë shumë lajme në horizont. Ju jeni arkitektët e fatit tuaj, kështu që duhet të lëvizni për të ndryshuar jetën tuaj të punës.



NE KETE DATE

Mensur Mamuti	FUTBOLLISTI SPANJOLL NË FOTO	FLORIRI	KLUBI I FUTBOLLISTIT NË FOTO	ARIA E VOGLË
BRETKOCA				
TABELË ORËSH				
TULUZ LOTREK				
GJERMANIA		KERIUMI LUI - I DEVOTSHMI, MBRETI I FRANKËVE		
SËMUNDIA E TOKËS, EPILEPSI				
SALLA FESTIVE E UNIVERSITETEVE				
AKTORE DHE KËNGËTYARE BELGE E VITEVE '80				TOKAT E PUNUARA

KOHA	ISH KLUBI I FUTBOLLISTIT NË FOTO	LIQEN NË FINLANDË	SKËNDER TEMALI	PJESËTARE E NJË FISË INDIGJEN TË AUSTRALISË	KOHA	NDËRTESE	SHTET NË AFRIKË
QYTET NË ZVICËR					PARADHËNIE PËR NJË GJË TË BLERË LLOJ THIKE BREZI		
VJETËRSIA						AUSTRIA LLOJ HIDROKARBURI (SH. PASHQ.)	ANGSTREMI DISENJATORI I MODËS, XHORXHO
LANTANI MATËS I TEMPERATURËS			APARATET INCIZUESE LLOJ MAJMUNI				
T							UDHËHEQ
LIQEN NË SHBA, NË KUFIN KANADANË (UJËVARRA)							MIHAL POPI VEND NË PORT PËR NGARKIMIN E ANIJEVE
SUEDIA		FSHATAR MIHAL STEFA					
ISH MODELE SOMALIANE - AMERIKANE					ELEMENT KIMIK (NE) TEMPERATURA		
NJERI QË BËN NJË JETË TË VETMUAR						KRASIT	

ZGJIDHJET: ZHABA, ORAR, RIRI, D, CE, ILET, AULA, LIO, BINA, VISP, KAPAR, ANTIKA, A, A, LA, KAMERAT, TERMOMETËR, NIAGARA, MP, S, KATUNDAR, IMAN, NEONI, ASKETI, KIJ.

Sudoku

shumë i lehtë

4		2	5					
			7		2	1	9	
		7				6		
6					9	8		
9								1
	2	5						3
	1	6			5		8	
	4		2		5			
				3				9

mesatar

				1				8
				2	6	5		
		6	5			1		9
9		2						
							2	5
5	1		8	6				
		3		1			9	
	2			7	4			
								5

Shumë i lehtë: 462591837, 583762194, 197438652, 671324985, 934856271, 825179463, 316947528, 749285316, 258613749. Mesatar: 325914786, 198726534, 746583129, 972435861, 684179253, 513862947, 857341692, 239657418, 461298375.

Aparati fotografik më i shtrenjtë në botë, 2.5 milionë euro

Një aparat fotografik shumë i rrallë është shitur në ankand për 2.5 milionë euro, duke e bërë më të shtrenjtin në botë. Leica është prodhuar në vitin 1923 dhe mendohet se vetëm 3 modele të tillë ekzistojnë në planet. Ankandi për shitjen e kësaj pajisjeje u mbajt në Vienë dhe çmimi fillestar ishte 400 000 euro. Pas "luftës" së ofertave, një koleksionist anonim nga Azia ariti ta blinte për 2.5 milionë euro, 6 herë më shumë sesa çmimi fillestar. Marka e famshme gjermane Leica prodhon aparatet më të mira sot për sot.



Ngordh në Kenia rinoceronti i fundit mashkull i bardhë

Sudan, rinoceronti i fundit i bardhë mashkull i bardhë, ka ngordhur në moshën 45-vjeçare në kopshtin zoologjik Ol Pejeta Conservancy në Kenia. Me zhdukjen e tij, kanë mbetur vetëm dy ekzemplare femra të kësaj specijeje. Njoftimi është dhënë nga ambientalisti ndërkombëtar WildAid, i cili shpjegon se si kafsha është vizituar nga një ekip veterinerësh, të cilët kishin konstatuar një përkeqësim të dukshëm të gjendjes së tij. Elodie Sampere, zëdhënësi i kopshtit zoologjik, ka shpjeguar gjithsesi që kampionët e spermës së kafshës janë ruajtur me shpresën e inseminimit artificial për dy rinocerontët femra të mbetura (Najin dhe Fatu, të dyja vajza të Sudanit), në mënyrë që të përpiqeshin të shpëtonin specien nga zhdukja.

Abuzimi me të dhënat, rritet presioni mbi Zuckerbergun

Themeluesi dhe shefi ekzekutiv i "Facebook"-ut, Mark Zuckerberg po përballlet me thirrje gjithnjë e më të shpeshta, që të paraqitet personalisht në panelet e hetimeve për sjelljen e rrjetit të tij social. Kompania është akuzuar se nuk i informoi përdoruesit, pasi informacionet e profileve të tyre ishin marrë dhe mbajtur nga "Cambridge Analytica", një firmë të dhënash që ndihmoi Donald Trumpin të fitojë zgjedhjet. Të premten, "Facebook" tha se kishte bllokuar qasjen e firmës britanike në platformën sociale, pasi kompania londineze nuk i kishte fshirë të dhënat e përdoruesve të marra në mënyrë të gabuar, siç kishte premtuar. Megjithatë premtoi se në vitin 2018 do ta riparonte "Facebook"-un, themeluesi i kompanisë Zuckerberg ia ka dalë të shmangetë përballjen

me numrin në rritje të kritikëve dhe ka dërguar avokatë apo shefa politikash në seancat e ndryshme dëgjimore. Debatimi për përdorimin e të dhënave të "Facebook"-ut për propagandë të shënjestruar politike ka bërë që shumë figura politike, nga të dyja anët e Atlantikut, të nxisin Zuckerbergun të dalë publikisht e të mbrojë, ose të paktën justifikojë, krijimin e tij.

Senatorë amerikanë dhe deputetë britanikë i bënë thirrje Zuckerbergut të paraqitet në komisionet hetimore, madje ka nga ata që thonë se do t'i dërgojnë edhe thirrje. "Facebook" dhe "Cambridge Analytica" nuk pranojnë faj për situatën e fundit, por analistët thonë se kritikët e fundit shkojnë drejt modelit të "Facebook"-ut për të bërë biznes dhe Zuckerberg duhet të bëjë diçka, përpara se stuhia të shndërrohet në uragan.



I shpërthen celulari duke folur, vdes 18-vjeçarja

Një vajzë 18-vjeçare indiane është vrarë nga celulari i saj, pasi pajisja shpërtheu ndërkohë që ajo ishte duke folur. Uma Oram e kishte telefonin në karikim kur po fliste me një të afërm kur ndodhi tragjedia në Odisha. Adoleshenta pësoi dëmtime të rënda në kokë, gjoks dhe këmbë. Ajo mbërriti e vdekur në spital. Fotot e telefonit që ka shpërthyer tregojnë se bëhet fjalë për një Nokia 5233, i dalë në treg në vitin 2010.



KALENDARI HISTORIK 21 MARS

630 - Perandori i Bizantit Heraklioti rikthen Kryqin e vërtetë në Jerusalemin.

1413 - Henri i V emërohet Mbret i Anglisë.

1697 - Cari Pjetri i Madh nis turneun e tij nëpër Evropën Perëndimore.

1788 - Zjarri në Nju Orleans shkatërron 856 ndërtesa.

1871 - Gazetari Henry M Stanley filloi ekspeditën e tij të famshme nëpër Afrikë.

1899 - Britania dhe Franca merren vesh për Afrikën Perëndimore.

1907 - SHBA pushton Hondurasin.

1935 - Persia zyrtarisht emërohet Iran.

1943 - Dështon tentimi për vrasje e Hitlerit.

1963 - Mbyllet burgu u njohur federal në San Francisko, Alkatraz.


2002 - Në Pakistan, Ahmed Omar Saeed Sheikh së bashku me tre të dyshuar të tjerë akuzohen për vrasje e tre të kidnapuarve dhe vrasjen e reporterit të Wall Street Journal Daniel Pearl.

100 miligramë kafeinë në ditë mjafton për t'i krijuar varësi nga kafja një të rrituri. Këtë sasi e përmbajnë dy bustina Lipton tea ose tre kannaçë Coca-Cola. Nëse ndërprisni pirjen e kafes menjëherë, mund të kenë simptomat e lënies së saj, mungesë energjie, nervozizëm, dhimbje koke.



Amerikanët konsumojnë 400 milionë filxhanë kafeje në ditë, që është 146 miliardë filxhanë kafe në vit.

Rruga më e ngushtë në botë është në Reutlingen të Gjermanisë. Quhet 'Spreuerhofstrasse' dhe është 31 centimetra e gjerë në pikën më të ngushtë.



VEÇ NJË TË METË

- Pi alkool?
- Jo.
- Duhan?
- Jo.
- Vjedh?
- Jo.
- Punon?
- Shumë.
- Ti qenke i përsosur për vajzën time.
- Zotëri, unë kam vetëm një të metë. Gënjej shumë.

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Fjalët e fundit para vdekjes janë për idiotët që nuk kanë thënë mjaftueshëm në jetën e tyre.

(Karl Marx)